

UNIVERISITETI I PRISHTINËS, „HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIM DIPLOME MASTER

Tema:

**NDIKIMI I KUSHTEVE TË PUNËS NË QËNDRIMIN E NXËNËSVE NDAJ LËNDËS SË
EDUKATËS FIZIKE NË SUKSES DHE DALLIMET NË MES GJINIVE TË MOSHËS SË
MESME SHKOLLORE**

Mentori:

Prof.Dr. Hasim Rushiti

Kandidati-tet:

Adelina Korpuzi
Arta Sylejmani
Myrvedete Aliaj

Prishtinë, 2017

Përmbajtja

Abstraki.....	1
1. Hyrja	3
2. Hulumtimet e deritanishme	6
3. Karakteristikat zhvillimore të moshë 15-18 vjeçare	9
3.1. Zhvillimi fizik.....	9
3.2. Zhvillimi kognitiv	10
3.3. Zhvillimi emocional.....	10
3.4. Zhvillimi social.....	11
4. Niveli i aktivitetit fizik tek të rinjtë e shkollës së mesme	12
5. Qëllimi i hulumtimit	14
6. Metodologjia e hulumtimit	15
6.1. Hipotezat.....	16
6.1.1. Pyetjet Hulumtuese:.....	16
6.1.2. Hipotezat:.....	16
6.2. Mostra e hulumtimit	17
6.3. Instrumentet dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave.....	18
6.4. Metodat për përpunimin e rezultateve	19
8 Analiza dhe diskutimi i rezultateve	20
8.1. Interpretimi i parametrave themelor statistikor	20
8.1.1. Grupimi i vajzave dhe djemve.....	20
8.1.2. Grupet e vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme të punës.....	23
8.1.3. Grupet e djemve nga shkolla me kushte të ndryshme të punës	26
8.1.4. Ndërlidhjet ndërmjet variablave (korelacionet) - vajzat	29
8.1.5. Ndërlidhjet ndërmjet variablave (korelacionet) – djemtë.....	31

8.1.6. Ndërlidhjet ndërmjet variablave (korelacionet) – vajzat nga shkollat me kushte të mira të punës	33
8.1.7. Ndërlidhjet ndërmjet variablave (korelacionet)– djemtë nga shkollat me kushte të mira të punës	36
8.1.8. Ndërlidhjet ndërmjet variablave (korelacionet) – vajzat nga shkollat me kushte jo të mira të punës	39
8.1.9. . Ndërlidhjet ndërmjet variablave (korelacionet)– djemtë nga shkollat me kushte jo të mira tëpunës	44
9. Ndryshimet në mes të grupeve	49
9.1. Ndryshimi në mes të vajzave dhe djemve	49
9.2.Ndryshimet në mes të vajzave nga shkollat me kushte të mira dhe kushte jo të mira të punës .	54
9.3.Ndryshimet në mes të djemve nga shkollat me kushte të mira dhe kushte jo të mira të punës.....	58
10. Vërtetimi i hipotezave	63
11. Përfundimi me rekomandime.....	64
12. Vlera teorike dhe praktike e punimit	67
13. Literatura	68
15. Pyetësi	70
16.Resyme.....	72

Abstrakti

Qëllimi:Hulumtimi ka për qëllim që të vërtetohen dallimet e qëndrimeve të nxënësve ndaj lëndës të Edukatës Fizike nëpër shkollat të cilat ofrojnë kushte të mira pune dhe të shkollave të cilat nuk ofrojnë kushte të mira pune në tri komuna të Kosovës,kumostrat janë përdorur nxënësit e shkollave të mesme të moshës 15-18 vjeç, gjithsej 1200 respondentë të të dy gjinive në nga dy lloj shkolla në tri komuna të ndryshme si në : Prizren, Therandë dhe Lipjan.

Przreni: Shkolla e Mesme e Lartë Ekonomike „Ymer Prizreni” - Me kushte të mira të punës.

Prizreni: Shkolla e Mesme e Lartë Teknike,„11 Marsi” - Me kushte jo të mira të punës.

Theranda: Shkolla e Mesme e Lartë Gjimnazi „Jeta e Re” - Me kushte të mira të punës.

Theranda: Shkolla e Mesme Teknike „ Skender Luarasi ” - Me kushte jo të mira të punës.

Lipjan:Shkolla e Mesme Gjimnazi „ Ulpiana” - Me kushte të mira të punës.

Lipjan: Shkolla e Mesme Profesionale „ Adem Gllavica ” - Me kushte jo të mira të punës

Në secilën komunë janë përfshirë nga 100 Meshkuj dhe 100 Femra.

Metodat:Në këtë hulumtim është shfrytëzuar pyetësi i standardizuar për matjen e qëndrimeve të nxënësve për edukimin fizik nga Jimmie Ishee i cili ka gjithsej 16 pyetje. Kurse për përpunimin e të dhënave është përdorur programi kompjuterik SPSS,version20.0. Ndërsa për përshkrim të grumbullimit dhe shpërndarjes së rezultateve si dhe relacionet korrelative në mes grupeve është aplikuar metoda e analizës diskriptive(përshkruese) statistikore. Si dhe T-testi për përcaktimin e rëndësisë statistikore, dallimet dhe komfirmimin e dallimeve në bazë të përcaktimit të respondentëve për nivelin e caktuar të deklaramentit.

Rezultatet:Është konstatuar se faktor i rëndësishëm janë kushtet e mira të punës në qëndrimet pozitive të nxënësve ndaj orës së edukatës fizike nga të dy gjinitë.

Fjalët kyçe: Nxënësit,Shkollat, Pyetësi, Dallimet,Ndërlidhjet.

Abstrakt

Purpose: The aim of the research is to verify the differences of student's attitudes towards the Physical Education subject in schools which offer good working conditions and schools that do not provide good working conditions in three municipalities of Kosovo where samples are used by students of middle school aged 15-18 years, a total of 1200 respondents of both sexes in two types of schools in three different municipalities, such as Prizren, Therandë and Lipjan.

Przrn: High School of Economics, "Ymer Prizreni" - Good working conditions.

Prizren: High Tech High School, March 11 "- With poor working conditions.

Theranda: High School Gymnasium, "New Life" - Good working conditions.

Theranda: Technical High School „, Skender Luarasi "- With poor working conditions.

Lipjan: High School "Ulpiana" High School - Good working conditions.

Lipjan: Vocational Secondary School "Adem Gllavica" - With poor working conditions

In each municipality are included 100 Men and 100 Women.

Methods: In this research a standardized questionnaire for measuring student attitudes for physical education by Jimmie Ishee has been used, which has a total of 16 questions. Data processing courses are SPSS software version 20.0. While describing the collection and dissemination of results as well as the correlation between the groups, statistical (descriptive) analysis method has been applied. As well as the T-test for determining the statistical significance, differences and the reinforcement of the differences based on the determination of the respondents for the given level of declaration.

Results: It is concluded that the good working conditions in the positive attitudes of students towards the physical education hour of both sexes are important factors.

Key words: Students, Schools, Questionnaire, Differences, Liaison.

1. Hyrje

Është e rëndësishme që të kuptojmë qëndrimet dhe perceptimet e nxënësve në drejtim të edukimit fizik pasi që ata do të jenë anëtarë të ardhshëm të fuqisë punëtore të cilët do të duhet të përdorin njohuritë e tyre për të mbajtur një mënyrë jetese të shëndetshme dhe me këtë do të sigurojnë që shëndeti i përgjithshëm i popullatës të përmirësohet. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë shumëfaktorë pasi që dihet se procesi i edukimit dhe formimit të personalitetit është problematikë shumëdimensionale. Shkenca e cila në vazhdimësi është në mbështetje të avancimit të praktikave shkollore bënë përpjekje për të gjetur modelet më të përshtatshme të cilat në kushte optimale do të ofronin rezultatet maksimale në arritjen e objektivave të synuara.

Organizimi dhe realizimi i kësaj lënde do t'i ndihmojë nxënësit të vlerësojnë efektet e padiskutueshme të saj në shumë drejtime, jo vetëm në aspektin fizik e sportiv por edhe në atë të marrëdhënieve midis njeri tjetrit, në atë të zgjerimit të njohurive në fushën e traditës kulturor të krahinave e të vendeve të ndryshme, në atë të krijimit të një mjedisi më shoqëror pasi në këto veprimtari nuk duhet të ketë të humbur por të gjithë fitojnë (MASH, 2008)

Qëndrimet e zhvilluara në një moshë të re të nxënësit për orën e edukimit fizik mund të ndryshojnë në bazë të kontekstit të situatës si p.sh mund të jetë mësimdhënësi ose mjedisi në klasë (Ajzen, 2001). Me fjalë të tjera, qëndrimi i një nxënësi ndaj një subjekti të veçantë në shkollë mund të jetë formuar nga perceptimi i tij / saj për mësimdhënësin ose organizimin e orës mësimore.

Pra, nga ajo që është vërtetuar nga hulumtimet e shumtë në këtë aspekt, shkaqet që ndikojnë në humbjen e motivit të nxënësve për mësim mund t'i grupojmë në:

- shkaqet brenda shkollore, dhe
- shkaqet jashtëshkollore (shoqërore).

Mirëpo, me gjithë këto përpjekje, me gjithë përmirësimin e dukshëm të praktikave pedagogjike shkollore dhe kurrikulat e reja, ende vërehen, bile në shkollë shqetësuese, dukuri negative që e shoqërojnë aktivitetet në shkollë, duke u shfaqur me humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, e si rrjedhojë me rritjen e numrit të orëve të humbura dhe me rënien e nivelit të mësimnxënies, sidomos nga kategori të caktuara

nxënësish, në të gjitha nivelet. Prandaj në këtë aspekt kemi mundur t'i identifikojmë disa nga shkaqet që ndikojnë në mospërfundimin e dëshiruar në mësim nga nxënësit si:

- mësimdhënia jo atraktive,
- sjellja jo korrekte ndaj kërkesave të nxënësve,
- mbingarkesat e planeve dhe e programeve mësimore,
- disiplina dhe rreptësia e tepërt në shkollë,
- papërshtatshmëria e mjedisit shkollor dhe
- presioni nga nxënës problematikë dhe të dhunshëm.

E rëndësishme për trajtimin e kësaj teme është të analizohet pika e cila ka të bëjë me papërshtatshmërinë e mjediseve shkollore e sidomos në rastin tonë papërshtatshmëria e hapësirave për praktikim të orës së edukatës fizike. Një faktor gjithsesi me peshë në procesin e përgjithshëm mësimor është edhe mjedisi shkollor, si ai i brendshëm, po ashtu edhe ai jashtëshkollor. Një mjedis i rregulluar mirë, i pastër dhe i pajisur me vegla dhe rekuizita të domosdoshme, me hapësirat dhe me ndriçimin e duhur, që ofron komoditetin e nevojshëm për nxënësit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në motivimin e nxënësve për mësim dhe në klimën e përgjithshme pozitive gjatë procesit mësimor. Po kështu mund të thuhet edhe për mjedise jashtëshkollore: një oborr i rregulluar mirë, me shtigjet për ecje, vrapim, lojëra sportive, me ulëset pushuese dhe me gjelbërimin e nevojshëm s'do mend se ndikon në krijimin e një klime të favorshme në shkollë dhe në motivimin e nxënësve për mësim. Ishte vërejtje e përgjithshme se përgjithësisht në shkollat tona mungon një kulturë e krijimit dhe e ruajtjes së mjediseve të përshtatshme brenda shkollës, në oborrit e shkollës dhe rreth shkollave, aspekt që në të ardhmen gjithsesi duhet kushtuar edhe rëndësi më të madhe institucionale.

S'ka dyshim se edhe faktorë të jashtëm mund të jenë shumë aktiv dhe po aq të dëmshëm që reflektojnë drejtpërdrejtë edhe në procesin mësimor, në mjedisin e përgjithshëm në shkollë, duke ndikuar edhe në humbjen e interesimit për mësim. Ndër këta faktorë si më i rëndësishmi në këtë aspekt del të jetë familja, përkatësisht gjendja e saj e përgjithshme, ekonomike dhe niveli i saj arsimor. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në klimën e përgjithshme në familje, e ajo drejtpërdrejt, nëpërmjet fëmijëve të tyre nxënës, reflekton në shkollë, në atmosferën e përgjithshme të saj dhe në punën e mësimdhënësve, qoftë kolektive

a individuale me nxënës,që në mënyrë të ndjeshme ndikon në rezultatet e mësimnxënëies dhe të shkollës në përgjithësi. Kështu nga shkaqet e jashtme të kësaj natyre mund t'i veçojmë:

- gjendja socio-ekonomike në familje,
- gjendja shëndetësore dhe psiko-fizike e nxënësve,
- rrethanat e përgjithshme shoqërore në arsimin e një vendi dhe
- pa perspektiva ekonomike në vend.

Nga ana tjetër edhe komunikimi mes shkollës dhe bartësve të aktiviteteve të lira në shkollë motivojnë nxënësit për mësim. Një aspekt i punës së përgjithshme në shkolla janë edhe aktivitetet e lira,të cilat kanë të bëjnë me angazhimin e nxënësve më të dalluar,përkatësisht të atyre me prirje të veçanta në lëmenjë të ndryshëm,gjithsesi nën mbikëqyrjen e mësimdhënësve apo të personelit tjetër kompetent në shkolla.Nga praktika e këtyre aktiviteteve në shkollat tona vërehet se bartësit e këtyre aktiviteteve angazhohen zakonisht para festave të ndryshme,qoftë me karakter shtetëror,qoftë edhe ato me karakter shkollor,por sidoqoftë,edhe për realizimin e këtyre aktiviteteve kulturore a sportive duhet të dëshmohet një kulturë e lartë komunikimi mes subjekteve të përfshira.S'mund të ketë rezultate të dallueshme,nuk mund të shënohen arritje të larta të këtyre aktiviteteve pa një kulturë profesionale,krahas talentit dhe vullnetit të nxënësve për të dëshmuar prirjet e tyre, në cilindo aktivitet qoftë.Kështu në nivel të shkollave janë të formuara seksione të ndryshme,janë të angazhuar bartësit konkretë dhe janë të përcaktuara datat e manifestimeve të ndryshme në përputhje me karakterin e festave,por që të shënohen rezultate të dukshme dhe të kënaqshme,duhet t'u paraprijë njëkomunikim jo vetëm profesional,por para së gjithash i kulturuar e motivues.Pikërisht motivi për t'i angazhuar nxënësit e talentuar në lëmenj të ndryshëm është parakushti themelor i arritjeve në realizimin e tyre në nivel të shkollës.

Qëndrimet ndaj aktivitetit fizik dhe përceptimet rreth orës së edukatës fizike janë të rëndësishme për të kuptuar se si ata mund të ndikojnë në vendimin e një individi për të filluar ose për të vazhduar pjesëmarrjen në një veprimtari (Silverman dhe Subramaniam,1999). Prandaj,nevoja për të studiuar qëndrimet e nxënësve ndaj programeve të tyre të edukimit fizik në shkollat tona është me rëndësi.Kjo mund të shihet si një përpjekje për të përmirësuar mënyrën e jetesës së rinisë sonë, duke u munduar të i largojmë nga dukuritë negative të cilat na rrethojnë dhe duke iu siguruar njohuri dhe aftësi të cilat do të ndikojnë vendimet e tyre për të ndjekur një jetesë aktive.

2. Hulumtimet e deritanishme

Në një numër të konsideruar të hulumtimeve të këtij lloji janë bërë përpjekje që të caktohen dhe të ndërlihen qëndrimet e nxënësve me përkushtimin e nxënësve në orën e edukimit fizik dhe me faktorët që i bëjnë nxënësit të jenë më të motivuar dhe të mbajnë qëndrime pozitive ndaj lëndës së edukatës fizike, dhe njëkohësisht gjetja e atyre faktorëve të cilët krijojnë ndjesi negative dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi ndikojnë që nxënësit të irritohen nga lënda e edukimit fizik dhe njëkohësisht të ulen niveli i aktivitetit të tyre lëvizorë, qoftë në shkollë apo në mjediset jashtëshkollore. Në literaturën botërore gjinden përpjekje të shumta që janë bërë nga autorë të ndryshëm për të identifikuar faktorët të cilët ndikojnë në krijimin e këtyre qëndrimeve. Fatkeqësisht hulumtimet në vendin tonë shumë pak, ose më mirë të thuhet se fare nuk e kanë trajtuar këtë çështje.

Identifikimi i faktorëve të mundshëm që kontribuojnë për qëndrimin e nxënësve për edukimin fizik në përgjithësi ka ndryshuar, me kalimin e kohës dhe me avancimin e vetë statusit të lëndës së edukimit fizik.

Në një nga studimet më të hershme të kësaj çështje është ai i **Nemson (1949)** i cili duke u përpjekur që të identifikoj shqetësimet e veçanta që nxisin studentët të kenë ndjenja negative ndaj edukimit fizik, ka zbuluar se djemtë me qëndrime pozitive ndaj edukimit fizik ishin më së shumti të shqetësuar nga vet-higjiena personale e mësimit të edukimit fizik (p.sh. erë e duhanit që vinte nga frymëmarrja e mësimit të edukimit fizik). Anasjelltas, djemtë të cilët u kategorizuan si grup që mbante qëndrim negativ ndaj edukimit fizik ishin të irrituar nga vetë kërkesa e mësimit të tyre se duhet të marrin pjesë në orën e edukimit fizik.

Kohët e fundit **Tannehill dhe Zakrajsek (1993)** nga hulumtimi i tyre gjetën se si të triumfoj suksesi, performanca e mirë, përfshirja në aktivitet, puna ekipore, argëtimi që ata përjetojnë paraqitësi faktorë shumë të rëndësishëm që në moshat e shkollës së mesme t'inxisin nxënësit që t'i perceptojnë si me përvoja pozitive në orën e edukimit fizik, dhe nga ana tjetër përvojat negative të tyre ishin të lidhura me stërvitjet palestër (sallë të gjimnastikës) dhe frika nga mundësia e lëndimit.

Carlson (1994) ka gjetur se qëndrimet e nxënësve ndaj edukimit fizik janë të ndikuara nga Kultura (gjinia, idealizmi i figurave të elitës sportive), shoqërinë (familjen, masmedia, përvoja sportive, niveli

i aftësive, kolegët, përvojat e mëparshme të edukimit fizik dhe perceptimet për fitnesin) dhe shkollën (ndikimin e mësimdhënësit).

Kërkime të tjera në vitin 1995 përcaktuan se " përshkruan dhe analizuan atë që studentët mendojnë, ndiejnë dhe dinë për aspekte të programeve të ndryshme të edukimit të tyre fizik "(**Graham 1995**). Hulumtuesit gjetën se 21% e të rinjëve, respektivisht nxënësit e shkollave të mesme që ishin të përfshirë në hulumtim, nuk u pajtuan fuqishëm me deklaratën, "Më pëlqejnë orët në palestër". Arsytet për pakënaqësi përfshinin: përmbajtjet e mësimi të parëndësishme, perceptimi i mungesë së aftësive, ekspozim publik i mangësive lëvizore, shqetësimi për konkurrencën dhe ndjenjat e izolimit (**Carlson, 1995**).

Portman (1995) gjatë studimit me nxënësit e klasave të gjashta gjithashtu gjeti se edukimi fizik ishte për një pjesë të nxënësve një përvojë të pakëndshme që çon në ndjenjat e izolimit, sikletit dhe poshtërimin.

(**Ajzen, 2001**). Ka gjetur se qëndrimet e zhvilluara në një moshë të re të nxënësit për orën e edukimit fizik mund të ndryshojnë në bazë të kontekstit të situatës si p.sh mund të jetë mësimdhënësi ose mjedisi në klasë. Me fjalë të tjera, qëndrimi i një nxënësi/e ndaj një subjekti të veçantë në shkollë mund të jetë formuar nga perceptimi i tij / saj për mësimdhënësin ose organizimin e orës mësimore.

(**Silverman dhe Subramaniam, 1999**). Kanë arritur në përfundim se qëndrimet ndaj aktivitetit fizik dhe perceptimet rreth orës së edukatës fizike janë të rëndësishme për të kuptuar se si ata mund të ndikojnë në vendimin e një individi për të filluar ose për të vazhduar pjesëmarrjen në një veprimtari.

Shoqata të ndryshme në botë që merren me edukimin fizik dhe sportiv në hulumtimet e tyre theksojnë se pjesëmarrja e nxënësve në një sport konkurrues apo në një aktivitet fizik shpesh japin përfitime të shumta jo vetëm në shëndetin fizik por edhe atë mendor. Kështu **Bailey dhe të tjerë (2013)** theksojnë se përfitimet e nxënësve në orën e edukimit fizik nuk janë autonome, të pavarura ose të shkyçura, por janë grupore dhe përforcojnë njëri-tjetrin d.m.th. shëndetin fizik dhe mendor.

Qëndrimet e nxënësve që fitohen gjatë orës së lëndës së edukatës fizike kanë rëndësi të veçantë pasi që respekton veten dhe të tjerët në situata loje dhe jashtë saj, duhet të jetë i përgjegjshëm për veprimet e veta, të jetë tolerant i përkushtuar, të ketë qëndrim pozitiv dhe gadishmëri për bashkëpunim.

Qëndrimi i nxënësve ka potencial të ndikojë në masë të madhe nënotat e tyre dhe kjo drejtpërdrejtë ndikon në sjelljen e tyre si dhe përpjekjet që ata vënë në punën e tyre. **Darling, Caldeell dhe Smith (2005)**, kanë matur në mostrën prej 3.761 nxënës qëndrimet e nxënësve amerikanë të shkollave të mesme, ku rezultatet e kësaj matje thonëse pjesëmarrësit e nxënësve në aktivitetet ekstra-kurrikulare kanë pasur qëndrime më pozitive në shkollë se sa ata nxënës të cilët nuk kanë marrë pjesë në këtë aktivitet. Për më tepër, ata theksojnë se aktiviteti fizik dhe sportiv ndikojnë pozitivisht te nxënësit në shkollë në atë shkollë sa të rinjët të ndjehen të lidhur me shkollën e tyre, aspiratat e të rinjve dhe sjelljet pozitive shoqërore të cilat ekzistojnë brenda në shkollën e tyre.

Bazuar në këtë literaturë është e qartë se për disa të rinjët të shkollave të mesme edukimi fizik i nxënësve në shkollë është një përvojë jo e këndshme, ndërsa për të tjerët kjo lëndë është e këndshme dhe ja vlen që të mësohen me të. Në secilin rast kur nxënësit rriten në moshë, qëndrimet pozitive ndaj edukimit fizik bien. Kjo sidomos vlen të përmendet kur merret parasysh rënia e nivelit të aktivitetit fizik që ndodh gjatë adoleshencës. Me fjalë të tjera, në moshat e adoleshentëve qëndrimet e drejta ndaj edukimit fizik bëhen më pak të favorshme dhe nivelet e aktivitetit fizik ulen.

Paralelizmi i këtyre dy tendencave tregon rëndësinë që në punën tonë të përditshme duhet siguruar një përvojë edukimi fizik i cili do të inkurajojë të rinjët dhe adoleshentët në mënyrë që të krijojnë përvoja të mira, në mënyrë që të sigurohemi që do të ndërtojnë qëndrime të tilla që garantojnë se kanë për të ruajtur një mënyrë jetese fizikisht aktive.

3. Karakteristikat zhvillimore të moshës 15-18 vjeç

Kjo periudhë e rritjes ka të bëjë me adoleshencën, periudhë kjo që është një fazë tranzicioni midis fëmijërisë dhe moshës madhore. Kjo moshë përfshin vitet nga 13 deri në 18 vjeç. Ndryshe nga periudha e latencës kjo moshë karakterizohet nga ndryshime themelore në të gjithë zhvillimin e fëmijës. Këtu arrihet pjekuria biologjike e cila çon më pas në atë seksuale. Ndodhin ndryshime të mëdha edhe në funksionimin intelektual, ku kalohet nga faza e të menduarit operacional konkret në atë të të menduarit logjik formal. Ndryshimet më të mëdha ndodhin në fushën emocionale e shoqërore. Në këtë moshë adoleshenti është në kërkim të identitetit të vet personal, kjo kërkesë përbën shpesh një burim konflikti midis adoleshentit dhe prindërve. Adoleshencia shoqërohet shpesh me kriza emocionale të cilat çojnë drejt shprehive negative si: alkoolit, drogës, shthurjes seksuale, sjelljeve vandaliste dhe dhunës që më pas sjellin pasoja tepër të rënda për të ardhmen e tyre. Problemet që ndeshen në adoleshencë ndryshojnë nga ato të fazave të mëparshme. Pjekuria seksuale çon në rrethana konfliktuale dhe është e domosdoshme që adoleshenti të pajiset me të gjitha njohuritë mbi seksualitetin, mjetet kontraceptive dhe rrezikun e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Në këtë periudhë adoleshentët marrin përsipër më shumë përgjegjësi, organizojnë aftësi dhe marrin vendime lidhur me zgjedhjen e profesionit të tyre, fitojnë më shumë aftësi për t'ju përshtatur rregullave të vendosura nga shoqëria dhe gjithashtu ata kërkojnë të mbështeten e mirëkuptohen nga të rriturit.

3.1. Zhvillimi fizik

- Puberteti vazhdon. Meshkujt vazhdojnë me ritmin e rritjes edhe në moshën 15 vjeç, në përgjithësi janë më shtatlartë, më të rëndë dhe më muskuloz se sa vajzat.
- Ndryshimet trupore dhe treguesit e zhvillimit seksuale janë më të dukshme në të dy gjinitë, te djemtë dhe vajzat.
- Vajzat pothuajse arrijnë lartësinë e tyre përfundimtare në këtë moshë 14 ose 15 vjeç.
- Te të dy gjinitë është i theksuar interesimi i lartë për pamjen e jashtme dhe këto paraqesin pothuajse shqetësimet kryesore për ta.
- Ekziston një nevojë në rritje për gjumë dhe pushim fizik.
- Ngathtësia lëvizore ndodhë si rezultat i rritjes së shpejtë fizike.

- Djemtë dhe vajzat ndjejnë nevojën për të qenë të aftë fizikisht dhe për të realizuar arritje të mëtejshme.

3.2. Zhvillimi kognitiv

- Të menduarit bëhet më abstraktë, me arsyetimin më të mirë dhe kureshtje më të lartë intelektuale.
- Të rinjët janë në gjendje për të kuptuar gjërat hipotetike, si edhe ato të vërteta.
- Djemtë dhe vajzat fillojnë të kuptojnë metafora, gjërat e dykuptimta dhe e thellojnë humorin.
- Të rinjët fillojnë të jenë të vetëdijshëm për pikat e forta të tyre dhe dobësitë e tyre në procesin e të nxënës.
- Fokusimi është në të tashmen, por ka një vetëdije më të lartë që lidhet me planifikimin e të ardhmes.
- Djemtë dhe vajzat jo gjithmonë janë të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tyre.
- Ndjenja e të qenit të gjithë-fuqishëm, të gjithë-ditur dhe të paprekshëm janë të zakonshme në këtë moshë.
- Djemtë dhe vajzat vazhdojnë të sfidojnë rregullat dhe kufizimet dhe fillojnë të vënë në pikëpyetje normat shoqërore.
- Ekziston një ndjenjë e fortë e drejtësisë, ndjenjë e theksuar për të dalluar të zezën nga e bardha, si dhe dinë të bëjnë arsyetimet morale se çka është e drejtë apo e gabuar.
- Djemtë dhe vajzat i hedhin poshtë vlerat e prindërve të tyre, derisa i zhvillojnë vlerat e veta.
- Harresa është gjë e zakonshme për këtë moshë.
- Qëllimet për të ardhmen, duke përfshirë qëllimet afatgjata, fillojnë të jenë të rëndësishme.

3.3. Zhvillimi emocional

- Djemtë dhe vajzat kërkojnë të pavarësohen, por vazhdojnë të ndjehen të siguar në strukturën dhe në kufijtë e vendosur nga prindërit dhe të rriturit e tjerë. Edhe pse të rinjët duan disa distancë nga prindërit e tyre, ata shpesh duan marrëdhënie të ngushta me të rriturit tjerë jashtë familjes.

- Ndjeshmëria dhe vetëdija më e lartë për vete, shpesh rezulton në drojë, ndjenjë të turpfit apo modestidhe një nevojë më të madhe për jetën private.
- Është rritur shqetësimi në lidhje me ndryshimet fizike dhe konfuzion mbi zhvillimin e hovshëm të seksualitetit. Besimi në pamjen fizike është e lidhur me vetë-respekt.
- Me rritjen e ndërgjegjësimit seksual mund të fillojë edhe eksperiencia seksuale.
- Djemtë dhe vajzat mund të bëhen kritik ose argumentues.
- Ekziston preokupim në rritje me konfrontizmin dhe një dëshirë që të mos të jenë ndryshe nga kolegët.
- Djemtë dhe vajzat kërkojnë pranim nga kolegët, por ende mbështeten në vlerat dhe udhëzimet e prindërve të tyre.
- Djemtë dhe vajzat përpiqen të kuptojnë se kush janë duke provuar stile të ndryshme të jetës, në kërkim të një modeli të përshtatshëm.
- Djemtë dhe vajzat shohin veten ndryshe kur ata janë me moshatarët në krahasim me atë kur ata janë me prindërit dhe mësuesit.

3.4. Zhvillimi social

- Miqësia dhe romanca janë gjithnjë e më të rëndësishme për ta.
- Marrëdhëniet thellohen dhe bëhen më të ndërsjellta dhe të besueshme.
- Djemtë dhe vajzat janë në gjendje të hapin veten e tyre dhe të shohin perspektivën e tjetrit në një marrëdhënie.
- Djemtë dhe vajzat janë në përpjekje për të krijuar identitetin e tyre të ndarë nga ajo e familjes së tyre.
- Presioni i kolegëve është në kulmin e tij. Djemtë dhe vajzat identifikohen me grupin, pranimi social është i rëndësishme për vetë-respekt.
- Në këtë moshë fillojnë disa takime (takimi në grupe (ahengjet), takime rasti dhe takime serioze).
- Anëtarët e grupit ndajnë interesat, stilet, veshjen, muzikën dhe aktivitete sociale të njëjta.

4. Niveli i aktivitetit fizik tek të rinjët e shkollës së mesme

Edhe pse të rinjët janë popullata me aktive, dy faktorë të veçantë e bëjnë më pak të mundshme për adoleshentet që të vazhdojnë një stil aktiv të jetës në moshën e rritur. Së pari, nivelet e aktivitetit fizik si tek meshkujt ashtu dhe tek femrat zbritet vazhdueshëm gjatë shkollës së mesme. Së dyti, nxënësit e shkollave së mesme nuk lidhen nëaktivitete fizike të rregullta të cilat mirëmbajnë apo përmirësojnë mirëqenien fizike, forcën dhe fleksibilitetin (YRBS, 2009).

Këto prirje janë treguar në rezultatet e sistemit kombëtare të mbikëqyrjes (YRBS) 2007, në hulumtimin e sjelljeve të rrezikshme të rinisë, ku hulumtimet janë realizuar në shkollë.

Nivelet e aktivitetit fizik :

- 34.7% ju përshtaten niveleve të rekomanduara të aktivitetit fizik.
- 53.6% ndoqën orët e edukatës fizike një apo më shumë ditë në javë.
- 70% nuk ndoqën orët e edukatës fizike për çdo ditë.
- 35% shikuan televizion mesatarisht dy apo tri orë në një ditë shkolle.
- 25% luajtën video lojëra apo lojëra kompjuterike ose përdoren një kompjuter mesatarisht 2 apo 3 orë në një ditë shkolle, për diçka që nuk ishte punë shkolle.

Hulumtimet gjithashtu tregojnë ndryshime të sjelljes së ushtrimeve, përforsim ndërmjet nxënësve të shkollës së mesme (Grunbaum et al. 2002; YRBS, 2001):

- 53.4% e nxënësve kanë bërë ushtrime force (p.sh pompa, ushtrime të stomakut dhe ngritje tëpeshave) mëshumë se 3 nga 7 ditët e javës, para studimit.
- Nxënësit meshkuj (62.8%) kanë marrë pjesë në ushtrime për forcim në mënyrë të konsiderueshme më shumë sesa nxënëset femra (44.5%). Ky ndryshim gjinore është identifikuar në të gjitha popullatat pa dallim race, entiteti apo klase.
- nxënësit e bardhë (54.8%) kishin marrë pjesë në ushtrime për forcim dallueshëm më shumë se sa nxënësit e zinj (47.9%).
- nxënësit në sallën e 9 (58.7%) kishin marrë më shumë pjesë në ushtrime për forcim sesa nxënësit e sallës së 10, 11 dhe 12 (përkatësisht 53.9%, 51.1%, 48%)

Fakti se e dijmë se është e shëndetshme që të jesh fizikisht aktiv, jo gjithmonë ndikon në nivelet e aktivitetit fizik të të rriturit, e sidomos për fëmijët kjo njohuri është edhe më me pak ndikim. Fëmijët i vënë më shumë rëndësi vlerës së një aktiviteti dhe nëse jo ata ndjehen kompetent dhe të kënaqur gjatë aktivitetit (Eard, Saunders, dhe Pate, 2007).

Për nxënësit që të vazhdojnë aktivitetet fizike gjatë kohës sa janë duke u rritur, hulumtimi tregon qartë se fëmijët dhe adoleshentët duhet të ndjehen në përgjithësi kompetent në aktivitetet fizike. Ata gjithashtu kanë nevojë për tu ndjerë konfidentë në aftësinë e tyre për ta arritur një qëllim specifik, (ndjenja e vet – efikasitetit). Vet efikasiteti sugjeron që fëmijët dhe adoleshentët besojnë se ata kanë një shans të kenë sukses. Kontrolli mbi rezultatet e bazuar në përpjekje është përfshirë në vet-efikasitet (Harter, 1999). Për të ndikuar në ndryshimet e fëmijëve, mësuesit duhet të dinë se si të motivojnë nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në sallë. Një tjetër komponent është që mësuesit duhet të dinë se si të ndihmojnë nxënësit për të arritur kënaqshmërinë ose të ndjehen të suksesshëm pas përpjekjes së tyre. Studentët janë të mësuar se pjesëmarrja dhe përpjekja mund të kuantifikohet gjatë aktivitetit duke e monitoruar frymarrjen dhe rrahjet e zemrës. Kuantifikimi i aktivitetit në këtë mënyrë është i rëndësishëm për fokusim në procesin e aktivitetit në vend të rezultatit.

Hulumtimet e fundit në aktivitetin fizik të fëmijëve dhe psikologjinë e të ushtruarit ofrojnë dëshmi të mjaftueshme të cilat arrijnë të sigurojnë mësuesit të edukimit fizik të cilët e kuptojnë shumë më mirë se si janë të motivuar fëmijët dhe ku qëndron dallimi në mes motivimit të fëmijëve dhe adoleshentëve. Ky kuptim mund të ndihmojë mësuesit të zhvillojnë strategji të punës në klasë që mund të ndihmojnë nxënësit që të kuptojnë rëndësinë e të qenit aktiv dhe të ndikojnë në ndryshimin e prirjes së pasivitetit fizik në adoleshencë.

5. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi është që të matim shkallën e qëndrimit të nxënësve ndaj orës së edukatës fizike dhe njëkohësisht të bëjmë edhe verifikimin e ndryshimeve në mes të nxënësve të cilët punojnë në shkollat të cilat posedojnë kushte të mira të punës dhe atyre që punojnë në kushte më të dobëta. Krahasimi i drejtpërdrejtështetëbërë në mes të nxënësve nga shkolla të cilat ofrojnë kushte të mira të punës (posedojnë Sallë dhe hapësira për punë) dhe shkollat të cilat nuk ofrojnë kushte të mira të punës: (Nuk posedojnë Sallë dhe hapësirë për realizimin e lëndës së edukatës fizike).

Është evident fakti se qasja e organizimit të mësimdhënies, në të gjitha lëndët mësimore, përfshinë këtu edhe edukatën fizike, ka pësuar ndryshime rrënjësore nëse krahasohet me modelet e përdorura para disa vitesh. Përderisa në sistemet edukative ku procesi mësimorë ka qenë i orientuar në zotërimin e përmbajtjeve të cilat paraprakisht kanë qenë të caktuara nga mësimdhënësi, tani procesi mësimorë kërkon rrugë për të gjetur mënyra që përmbajtjet programore të shkoqiten në atë mënyrë që nxënësi të jetë pjesë aktive gjatë të nxënësit. E tërë kjo kërkon që mësimdhënësi të jetë shumë aktiv në procesin e përgatitjes së planeve mësimore në mënyrë që të gjej strategji, të përdorë metoda dhe të konstruktoj situatat problemore të cilat njëkohësisht sfidojnë por edhe motivojnë nxënësit gjatë orës së edukimit fizik.

Natyrisht se këto kërkesa të shtuara kërkojnë edhe kushte të mira të punës dhe se është vështirë të besohet se lënda e edukatës fizike do të arrijë të përmbushë qëllimet e veta në mungesë të kushteve adekuate për punë.

Bazuar në të gjitha këto objektivat specifike të punimit janë:

- Të gjurmohen dallimet në qëndrim ndaj aktivitetit fizikë që egzistojnë në mes të gjinive të nxënësve të shkollës së mesme.
- Të gjurmohen dallimet të cilat shfaqen në qëndrimin e nxënësve ndaj vlerës së aktivitetit fizik të cilat vijnë si rezultat i punës në shkolla me kushte të ndryshme të punës.
- Të nxjerren konkludime të cilat do shërbejnë si bazë për rekomandim të intervenimit konkret në përmirësim të kushteve të punës në lëndën e edukatës fizike.

6. Metodologjia e hulumtimit

Lloji i këtij hulumtimi i përket hulumtimit kuantitativ (sasior). Për ta realizuar punimin nga ana teorike janë përdorur metodat përmes së cilave është arritur ta sqarojmë më tej duke dhënë mbështetje shkencore të përkufizimeve dhe nocioneve që kanë të bëjnë me shkallën e qëndrimeve të caktuara ndaj aktivitetit fizikë dhe orës së edukatës fizike në përgjithësi.

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të këtij hulumtimi janë përdorur metodat e analizimit të literaturës nga fusha prej të cilave është konstruktuar problematike dhe gjetjet e ngjajshme janë bartë dhe krahasuar edhe me gjetjet nga pyetësorët të cilët janë përdorur për hulumtimin specifik që është realizuar me mostrën e nxënësve nga shkollat e Kosovës.

Metodat të cilat janë përdorë janë :

- 1) Analizimi i literaturës
- 2) Metoda krahasuese
- 3) Metoda statistikore
- 4) Metoda konkluduese.

6.1. Hipotezat

Ndërtimi i problematikës së hulumtimit por edhe parashtrimi të hipotezave i ka paraprirë edhe ngritja e disa pyetjeve hulumtuese në të cilat kemi ardhë si rezultat i hulumtimeve të mëparshme të problematikës së natyrës së ngjashme. Këto pyetje janë ngritur duke ditur faktin se në shkollat e Kosovës, në shumicën e rasteve ora e edukatës fizike mbahet në kushte jo të mira të punës dhe se nisur nga literatura kjo domosdo do të ndikonte edhe në shkallën e motivimit të nxënësve por edhe në ndërtimin e qëndrimeve të cilat ata i mbajnë ndaj aktivitetit fizike dhe vetë orës së edukatës fizike.

Pyetjet hulumtuese kanë qenë:

6.1.1. Pyetjet hulumtuese:

1. A ka dallim në mes të nxënësve meshkuj dhe femra të shkollës së mesme, sa i përket qëndrimit pozitiv apo negativ ndaj orës së edukimit fizik.
2. A ekzistojnë dallime në nivelin e qëndrimeve të nxënësve të nxënësve femra të cilët punojnë në shkollë me kushte të ndryshme.
3. A ekzistojnë dallime në nivelin e qëndrimeve të nxënësve të nxënësve meshkuj të cilët punojnë në shkollë me kushte të ndryshme.

6.1.2. Hipotezat:

H1: Nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme në mes dy gjinive, sa i përket ndryshimeve në qëndrim ndaj edukatës fizike.

H2: Nxënësset vajza të cilët punojnë në shkollë të cilat ofrojnë kushte më të mira të punës kanë qëndrim më pozitiv se nxënësset të cilët ndjekin shkollat me kushte jo të mira të punës.

H3: Nxënësit meshkuj të cilët punojnë në shkollë të cilat ofrojnë kushte më të mira të punës kanë qëndrim më pozitiv se nxënësit të cilët ndjekin shkollat me kushte jo të mira të punës.

6.2. Mostra e hulumtimit

Mostër e hulumtimit janë nxënësit e shkollave të Mesme të moshës 15 -18 vjeç. Mostra përbëhet nga gjithsej 1200 respondentë.

Shkollat të cilat janë përfshirë në hulumtim janë dy lloj shkolla në tri komuna të ndryshme: Prizren, Therandë, Lipjan.

Prizreni: Shkolla e Mesme e Lartë Ekonomike „Ymer Prizreni” - Me kushte të mira të punës.

Prizreni: Shkolla e Mesme e Lartë Teknike, „11 Marsi” - Me kushte jo të mira të punës.

Theranda: Shkolla e Mesme e Lartë Gjinnazi, „Jeta e Re” - Me kushte të mira të punës.

Theranda: Shkolla e Mesme Teknike, „Skender Luarasi” - Me kushte jo të mira të punës.

Lipjan: Shkollat e Mesme Gjinnazi „Ulpiana” - Me kushte të mira të punës.

Lipjan: Shkolla e Mesme Profesionale, „Adem Gilavica” - Me kushte jo të mira të punës.

Në secilën komunë janë përfshirë nxënësit nga shkollat të cilat ofrojnë kushte të mira të punës (Posedojnë sallë dhe hapësira për punë): 100 Meshkuj dhe 100 Femra, dhe shkolla të cilat nuk ofrojnë kushte të mira të punës: (Nuk posedojnë sallë dhe hapësirë për punë) 100 Femra dhe 100 Meshkuj.

Kriteri për përcaktimin e kushteve të punës ka qenë ekzistimi i sallës së sportit dhe posedimin i veglave dhe rekuizitave të punës si dhe kushteve tjera përcjellëse për të realizuar si duhet orën e edukatës fizike. E kundërta e kësaj është bërë përzgjedhja e shkollave të cilat nuk ofrojnë kushte të mira të punës që nënkupton se nuk posedojnë sallë dhe se nuk kanë vegla për realizimin e përmbajtjeve programore nga lënda e edukatës fizike. Po ashtu këto shkolla kanë edhe mungesë të hapësirave të hapura dhe nënjarë mënyrë nuk ofrojnë kurrfarë kushtesh për punë të mirëfilltë.

Përcaktimi i shkollave është bërë përmes mostrës oportune dhe nuk ka pasur ndonjë metodë të sofistikuar për seleksionim. Kjo nënkupton se jemi përcaktuar që pyetësorët i realizojmë në ato shkolla ku më së miri na janë përshtatur mundësit e qasjes më të lehtë.

6.3. Instrumentet dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave

Për studimin e këtij hulumtimit është shfrytëzuar pyetësi i standardizuar për matjen e qëndrimeve të nxënësve për edukimin fizik, pyetësi standard i JimmieIshee i cili ka gjithsej 16 pyetje. Ky pyetësor është mjaftë i thjeshtë dhe ka qenë e lehtë të administrohet nga nxënësit dhe njëkohësisht ka mundësuar edhe plotësimin pa gabime dhe me saktësi nga ana e nxënësve. Ky pyetësor quhet „Pyetësi për matjen e qëndrimeve ndaj aktivitetit fizik”. Ky pyetësor për herë të parë është publikuar në vitin 1970 si pjesë e librit të publikuar, „Konceptet që kanë të bëjnë me Edukimin Fizik”. Edhe pse pyetësi origjinal në gjuhën angleze është testuar për karakteristikat e tij metrike dhe validitetin e pyetjeve. Në gjuhën shqipe ky pyetësor vetëm është përkthyer nga persona kompetent të gjuhës, por nuk ka pasur procedurë të validimit të tij për përdorim. Fakti se pyetësi përbëhet nga pyetje mjaftë të thjeshta na bënë të shpresojmë se rezultatet e fituar kanë nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë. Pyetësi është i bashkëngjitur dhe i sqaruar në aneksin e projekt-propozimit.

Të dhënat janë grumbulluar në atë mënyrë që së pari është siguruar leja nga drejtorët e shkollave përkatëse për të siguruar qasje të nxënësit e shkollave. Të gjithë mësuesit e Edukatës Fizike në shkollat e përfshira në hulumtim janë takuar dhe ju është dhënë sqarimi i nevojshëm në lidhje me qëllimin dhe strukturën e pyetësit si dhe mënyrën e plotësimit të tij.

Në secilën klasë ku janë shpërndarë pyetësit, përveç mësuesve të edukatës fizike, kemi qenë prezent edhe vetë ne dhe kemi ndarë 30 minuta kohë për të dhënë sqarime para se të fillohet me plotësimin e pyetjeve. Përveç instruksioneve teknike një pjesë e sqarimeve ka qenë e lidhur edhe me motivimin e nxënësve për dhënien e përgjigjeve sa më reale në mënyrë që procesi të jap rezultatet maksimale. Të dhënat janë grumbulluar gjatë muajve Mars, Prill dhe Maj të vitit 2017.

6.4. Metodatat për përpunimin e rezultateve

Për përpunimin e të dhënave në këtë hulumtim është përdorur programi kompjuterik SPSS, version 20. Me qëllim të fitimit të një pasqyre sa më të qartë të gjendjes do të aplikohen metoda statistikore të cilat i ndihmojnë përmbushjes së hipotezave të parashtruara.

Për përshkrim të grumbullimit dhe shpërndarjes së rezultateve si dhe relacioneve korrelative të cilat ekzistojnë në mes të grupeve do të aplikohen metodatat standarde të analizës deskriptive (përshkruese) statistikore.

Mean - mesia aritmetik,

Min - rezultati minimal,

Max - rezultati maksimal,

Std.Dev - devijimi standard,

St.error - gabimi standard i mesatares aritmetikore,

Me qëllim të nxjerrjes së konkludimeve për dallimet domethënëse statistikore janë përdorur dy metoda standarde.

T – testi – Për përcaktimin e rëndësisë statistikore të dallimeve dhe konfirmim të dallimeve në bazë të përcaktimit të respondentëve për nivelin e caktuar të deklaramentit.

8. Analiza dhe diskutimi i rezultateve

8.1. Interpretimi i parametrevë themelore statistikore

8.1.1. Grupi i vajzave dhe djemve

Në tabelën Nr.1, janë paraqitur vlerat e parametrevë themelore statistikore për grupin e vajzave dhe tëdjemve. Pasi që kemi të bëjmë me vlerësime të realizuara sipas shkallës së Likertit me pesë nivele të ndryshme të pajtueshmërisë atëherë në parametrat statistikë përshkruese janë paraqitur vetëm vlera e tendencës qendrore. Testimi i normalitetit të shpërndarjes së rezultateve nuk preferohet për të dhëna të tilla.

Nga analiza e të dy tabelave vërejmë se vlerat më të larta të mesatares aritmetike të dy grupet janë realizuar në pyetjet 5, 13, 15 dhe 16. Vlera e mesatare aritmetike në këtë pyetje janë mbi 4, që tregon se kemi një shkallë të lartë të pajtueshmërisë nga të dy gjinitë në pyetjet si **„Edukimi fizik është një mënyrë për tu larguar nga brengat dhe tensionet e jetës së përditshme”**, **„Secili duhet të ketë njohuri dhe shkathtësi në disa sporte të cilat mund të përdoren më vonë në jetë”**, **„Shëndeti dhe fitnesi fizik janë kryesoret për të gjitha aktivitetet tjera jetësore”** dhe **„Unë do të rekomandoja që secili të merr orën e edukatës fizike si një nga orët më të rëndësishme”**.

Vlerat më të ulta janë realizuar në pyetjet 1, 11 dhe 14, ku vlerat mesatare sillen rreth vlerës dy. Kjo vlerë e realizuar në pyetje: **„Edukimi Fizik është për ata që e pëlqejnë sportin por nuk është për mua”**, **„Garimi në sport shpeshherë është një mënyrë për të shkatërruar miqësinë e mirë”** dhe **„Vallëzimet shoqërore dhe format e ngjashme të aktivitetit janë humbje kohe”**, tregojnë se respondentët e të dy gjinive nuk janë pajtuar në masë të madhe me pohimet e pyetjeve të parashtruara. Në pyetjet tjera vlerat e mesatare aritmetike janë më shumë të balancuara dhe sillen kryesisht rreth vlerës e cila tregon nivel mesatare të pajtimit me pohimet e parashtruara.


Në përgjithësi tabelat deskriptive e të dy gjinive tregojnë se kemi afërsisht një koncentrim të vlerave mesatare afërsisht të njëjta dhe se përgjigjet e dy grupeve mund të konsiderohen si pozitive në kuptimin e vlerësimit të qëndrimeve qendrore të kanë ndaj aktivitetit të rregullt fizikë dhe me këtë edhe ndaj orës së edukatës fizike. Për dallime më specifike do të krahasohen mesataret me metoda të cilat drejtpërdrejtë e përcaktojnë rëndësinë statistikore për pyetjet e caktuara.

Tab. 1. Parametrat themelore statistikore te vajzave dhe djemve

Grupet sipas gjinisë = Vajza							
	N	Mean	Median	Mode	Std. Dev	Min	Max
	Valid						
P1	600	2.31	2.00	2	1.382	1	5
P2	600	2.52	2.00	2	1.306	1	5
P3	600	2.45	2.00	2	1.215	1	5
P4	599	3.96	4.00	4	1.008	1	5
P5	600	4.26	5.00	5	.987	1	5
P6	600	3.77	4.00	4	1.076	1	5
P7	600	2.75	2.00	2	1.314	1	5
P8	600	2.42	2.00	2	1.308	1	5
P9	600	3.60	4.00	4	1.131	1	5
P10	600	2.83	3.00	2	1.399	1	5
P11	600	2.23	2.00	1	1.279	1	5
P12	600	3.52	4.00	4	1.120	1	5
P13	600	4.05	4.00	4	.959	1	5
P14	600	2.20	2.00	2	1.233	1	5
P15	600	4.03	4.00	5	1.063	1	5
P16	600	4.00	4.00	5	1.235	1	5

Grupet sipas gjinisë = Djem							
	N	Mean	Median	Mode	Std. Dev	Min	Max
	Valid						
P1	600	2.06	2.00	1	1.298	1	5
P2	600	2.51	2.00	2	1.276	1	5
P3	600	2.37	2.00	2	1.263	1	5
P4	600	3.83	4.00	4	1.111	1	5
P5	600	4.08	4.00	5	1.093	1	5
P6	600	3.71	4.00	4	1.055	1	5
P7	600	2.67	2.00	2	1.283	1	5
P8	600	2.45	2.00	2	1.266	1	5
P9	600	3.68	4.00	4	1.176	1	5
P10	600	2.86	3.00	2	1.375	1	5
P11	600	2.41	2.00	1	1.341	1	5
P12	600	3.49	4.00	4	1.161	1	5
P13	600	3.93	4.00	4	1.057	1	5
P14	600	2.44	2.00	2	1.259	1	5
P15	600	4.04	4.00	5	1.051	1	5
P16	600	4.14	5.00	5	1.143	1	5

Dallimet mes Vajzave dhe Djemve



	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	P10	P11	P12	P13	P14	P15	P16
■ Djem	2.06	2.51	2.37	3.83	4.08	3.71	2.67	2.45	3.68	2.86	2.41	3.49	3.93	2.44	4.04	4.13
■ Vajza	2.31	2.52	2.45	3.96	4.26	3.77	2.75	2.42	3.60	2.83	2.23	3.52	4.05	2.20	4.03	4.00

■ Djem ■ Vajza

8.1.2. Grupet e vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme të punës

Në tabelën Nr. 2, janë paraqitur vlerat e parametrave themelorë statistikore për grupin e vajzave nga shkollat me kushte të ndryshme të punës. Pasi që kemi të bëjmë me vlerësime të realizuara sipas shkallës së Likertit me pesë nivele të ndryshme të pajtueshmërisë atëherë në parametrat e statistikës përshkruese janë paraqitur vetëm vlera e tendencës qëndrore. Testimi i normalitetit të shpërndarjes së rezultateve nuk preferohet për të dhëna të tilla.

Nga analiza e të dy tabelave vërejmë se vlerat më të larta të mesatares aritmetike të dy grupet janë realizuar në pyetjet 4,5,13,15 dhe 16. Vlera e mesatares aritmetike në këtë pyetje janë mbi 4, që tregon se kemi një shkallë të lartë të pajtueshmërisë nga të dy gjinitë në pyetjet si, **„Mua më së shumti më pëlqen të marr pjesë në ato aktivitete në të cilat mund të përfshihem në punë ekipore”**, **„Edukimi fizik është një mënyrë për tu larguar nga brengat dhe tensionet e jetës së përditshme”**, **„Secili duhet të ketë njohuri dhe shkathtësi në disa sporte të cilat mund të përdoren më vonë në jetë ”**, **„Shëndeti dhe fitnesi fizik janë kryesoret për të gjitha aktivitetet tjera jetësore”** dhe, **„Unë do të rekomandoja që secili të merr orën e edukatës fizike si një nga orët më të rëndësishme”**.

Vlerat më të ulëta janë realizuar në pyetjet 1,11 dhe 14, ku vlerat mesatare sillen rreth vlerës dy. Kjo vlerë e realizuar në pyetje: **„Edukimi Fizik është për ata që e pëlqejnë sportin por nuk është për mua”**, **„Garimi në sport shpeshherë është një mënyrë për të shkatërruar miqësinë e mirë”** dhe **„Vallëzimet shoqërore dhe format e ngjashme të aktivitetit janë humbje kohe”**, tregojnë se respondentët e të dy gjinive nuk janë pajtuar në masë të madhe me pohimet e pyetjeve të parashtruar. Në pyetjet tjera vlerat e mesatareve aritmetike janë më shumë të balancuara dhe sillen kryesisht rreth vlerës e cila tregon nivel mesatarë të pajtimit me pohimet e parashtruar.


Edhe në këtë rast nuk mund të konkludohet se vlerat e tabelave tregojnë se edhe te vajzat e shkollave me kushte të ndryshme të punës kemi pothuajse një shpërndarje të njëjtë të niveleve të pajtueshmërisë sa i përket pajtimet apo mospajtimet me pohimet të cilat vijnë nga pyetjet e parashtruar në pyetësorë, dhe është e vështirë që në bazë të këtyre vlerave të gjendet ndonjë dallim i theksuar në mes grupeve.

Tab. 2. Parametrat themelore statistikore të vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme të punës

Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës							
	N	MA	Mediana	Modi	Dev. Std	Min	Max
	Valid						
P1	300	2.19	2.00	1	1.311	1	5
P2	300	2.47	2.00	2	1.241	1	5
P3	300	2.33	2.00	2	1.160	1	5
P4	299	3.96	4.00	4	.924	1	5
P5	300	4.22	5.00	5	1.054	1	5
P6	300	3.61	4.00	4	1.097	1	5
P7	300	2.69	2.00	2	1.288	1	5
P8	300	2.46	2.00	2	1.307	1	5
P9	300	3.53	4.00	4	1.113	1	5
P10	300	2.71	3.00	2	1.349	1	5
P11	300	2.12	2.00	1	1.222	1	5
P12	300	3.45	4.00	4	1.133	1	5
P13	300	3.97	4.00	4	.974	1	5
P14	300	2.11	2.00	1	1.169	1	5
P15	300	4.05	4.00	5	1.079	1	5
P16	300	3.88	4.00	5	1.251	1	5

Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës							
	N	MA	Mediana	Modi	Dev. Std	Min	Max
	Valid						
P1	300	2.42	2.00	2	1.441	1	5
P2	300	2.57	2.00	1	1.368	1	5
P3	300	2.56	2.00	2	1.259	1	5
P4	300	3.96	4.00	4	1.087	1	5
P5	300	4.29	5.00	5	.917	1	5
P6	300	3.92	4.00	4	1.033	1	5
P7	300	2.81	3.00	2	1.339	1	5
P8	300	2.39	2.00	2	1.310	1	5
P9	300	3.67	4.00	4	1.146	1	5
P10	300	2.94	3.00	2	1.441	1	5
P11	300	2.34	2.00	1	1.328	1	5
P12	300	3.59	4.00	4	1.104	1	5
P13	300	4.13	4.00	4	.938	1	5
P14	300	2.30	2.00	2	1.289	1	5
P15	300	4.01	4.00	5	1.049	1	5
P16	300	4.11	5.00	5	1.209	1	5

Vajzat me kushte të mira dhe jo të mira të punes



	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	P10	P11	P12	P13	P14	P15	P16
KJM	2.42	2.57	2.56	3.96	4.29	3.92	2.81	2.39	3.67	2.94	2.34	3.59	4.13	2.30	4.01	4.11
KM	2.19	2.47	2.33	3.96	4.22	3.61	2.69	2.46	3.53	2.71	2.12	3.45	3.97	2.11	4.05	3.88

■ KJM ■ KM

8.1.3. Grupet e djemve nga shkolla me kushte të ndryshme të punës

Në tabelën Nr. 3, janë paraqitur vlerat e parametrave themelorë statistikorë për grupin e djemve nga shkollat me kushte të ndryshme të punës. Pasi që kemi të bëjmë me vlerësime të realizuara sipas shkallës së Likertit me pesë nivele të ndryshme të pajtueshmërisë atëherë në parametrat e statistikës përshkruese janë paraqitur vetëm vlera e tendencës qendrore. Testimi i normalitetit të shpërndarjes së rezultateve nuk preferohet për të dhëna të tilla.

Nga analiza e të dy tabelave vërejmë se vlerat më të larta të mesatares aritmetike të të dy grupet janë realizuar në pyetjet 5, 13, 15 dhe 16. Vlera e mesatares aritmetike në këtë pyetje janë mbi 4, që tregon se kemi një shkallë të lartë të pajtueshmërisë nga të dy gjinitë në pyetjet si „ **Edukimi fizik është një mënyrë për tu larguar nga brengat dhe tensionet e jetës së përditshme**”, „ **Secili duhet të ketë njohuri dhe shkathtësi në disa sporte të cilat mund të përdoren më vonë në jetë**” , „ **Shëndeti dhe fitnesi fizik janë kryesoret për të gjitha aktivitetet e tjera jetësore**” dhe „ **Unë do të rekomandoja që secili të merr orën e edukatës fizike si një nga orët më të rëndësishme**”. Edhe pse vlera më të larta kemi në grupin e djemve nga shkolla me kushte të mira të punës.

Vlerat më të ulta janë realizuar në pyetjet 1 dhe 3, ku vlerat mesatare sillen rreth vlerës dy. Kjo vlerë e realizuar në pyetje: „ **Edukimi Fizik është për ata që e pëlqejnë sportin por nuk është për mua**” , „ **Unë kënaqem me pjesëmarrjen në sport po aq sa kam dëshirë të largohem nga ai**” Ku vlera më të larta kanë treguar grupi i djemve nga shkollat me kushte jo të mira të punës.

Nga këto rezultate shihet se në shumicën e ndryshoreve janë realizuar vlera të nivelit mesatarë të pajtueshmërisë dhe vetëm në disa prej tyre kemi tregues të dallimeve si dhe të animit të dukshëm ka vlerat më të larta apo më të ulëta të pajtueshmërisë të cilat do të vërtetohen me metodat adekuate të kondensimit të rezultateve.


Krahasuar me grupin e vajzave, në grupin e meshkujve të cilët vijnë nga shkolla me kushte të ndryshme të punës mund të konkludoj se pasqyra e gjendjes është më e qartë dhe jep më shumë për tu kuptuar se dallimet janë më të theksuara sa i përket shprehjes së qëndrimeve në lidhje me edukimin fizikë.

Tab. 3. Parametrat themelorë statistikore të djemve nga shkolla me kushte të ndryshme të punës

Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës							
	N	Mean	Median	Mode	Std. Dev	Min	Max
	Valid						
P1	300	1.93	2.00	1	1.160	1	5
P2	300	2.43	2.00	2	1.218	1	5
P3	300	2.25	2.00	2	1.157	1	5
P4	300	3.88	4.00	4	1.064	1	5
P5	300	4.24	4.50	5	.966	1	5
P6	300	3.63	4.00	4	1.012	1	5
P7	300	2.46	2.00	2	1.152	1	5
P8	300	2.37	2.00	2	1.224	1	5
P9	300	3.79	4.00	4	1.069	1	5
P10	300	2.87	3.00	2	1.361	1	5
P11	300	2.24	2.00	1	1.315	1	5
P12	300	3.46	4.00	4	1.104	1	5
P13	300	4.02	4.00	4	1.005	1	5
P14	300	2.49	2.00	2	1.242	1	5
P15	300	4.18	4.00	5	.903	1	5
P16	300	4.21	5.00	5	1.065	1	5

Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës							
	N	Mean	Median	Mode	Std. Dev	Min	Max
	Valid						
P1	300	2.20	2.00	1	1.411	1	5
P2	300	2.59	2.00	2	1.330	1	5
Nëse e krahasojmë vlerën në të gjitha pyetjet tjera vlera e T-testit, dhe niveli i significancës plotësojnë kriterin e vlefshmërisë statistikore për vërtetimin e ndryshimit të rëndësishëm statistikor. Në të gjitha rastet ku janë paraqitur ndryshime të vlefshme statistikore, vlera e significancës është më e ulët se 0.05.

Në bazë të këtyre rezultateve të fituara me anë të metodës së T- testit, me të cilën janë hulumtuar ndryshimet në mes të grupit të djemve dhe vajzave që kanë të bëjnë me qëndrimin të cilin kanë të gjithë të hulumtuarit për vlerën e fitnesit dhe aspektet tjera të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me të qenit aktiv, mund të konstatojmë se grupi i djemve ka treguar rezultate të cilat tregojnë interesim

më të lartë dhe qëndrime më pozitive ndaj vlerës së aktivitetit fizik. Në pyetjen e parë, **„Edukimi Fizik është për ata që e pëlqejnë sportin por nuk është për mua”**, vlera e $F=12.753$, sig. = 0.002 dallimi është se vajzat kanë realizuar mesatare më të lartë sa i përket deklarimit miratues ndaj këtij pohimi. Në pyetjen e katërt, **„Mua më së shumti më pëlqen të marr pjesë në ato aktivitete në të cilat mund të përfshihem në punë ekipore”**, vlera e $F=13.499$, sig. = 0.30, edhe në këtë rast vajzat kanë realizuar mesatare më të lartë. Kjo tregon se vajzat janë shprehur më të prirura se meshkujt që më shumë të angazhohen në punë ekipore. Në pyetjen e pestë, **„Edukimi fizik është një mënyrë për tu larguar nga brengat dhe tensionet e jetës së përditshme”**, $F=2.090$, sig. = 0.030, edhe në këtë rast kemi deklarim me vlera më të larta nga ana e vajzave. Vajzat janë më shumë të prirura për ta parë përfshirjen në aktivitete të rregullta dhe në orën e edukimit fizik si një mjet për t'u larguar nga brengat dhe tensionet që i shkaktojnë ngarkesat e përditshme. Në pyetjen e njëmbëdhjetë, **„Garimi në sport shpeshherë është një mënyrë për të shkatërruar miqësinë e mirë”** $F=7.745$, sig. = 0.18. Në këtë pyetje djemtë kanë treguar vlera më të larta të mesatarës dhe këto ndryshime janë domethënëse në kuptimin e vlerave statistikore në krahasim me grupin e vajzave. Natyrisht se kjo vije si rezultat i përfshirjes më të madhe të djemve në aktivitete që kanë karakter garues. Nga përvojat më të shumta që kanë shprehur edhe bindjen se kjo mund edhe të ndikojë në prishjen e miqësisë si rezultat i konflikteve dhe paknaqësive të cilat përcjellin garat sportive. Pyetja e trembëdhjetë, **„Secili duhet të ketë njohuri dhe shkathtësi në disa sporte të cilat mund të përdoren më vonë në jetë”**, $F=3.276$, sig. = 0.45, vajzat kanë treguar nivel më të lartë të mesatarës aritmetike se sa djemtë. Kjo tregon se vajzat konsiderojnë se është e rëndësishme që secili të zhvillojë shkathtësi të caktuar të cilat ju nevoiten më vonë në jetë. Dallimi i cili paraqitet në krahasim me djemtë me siguri vije si rezultat i faktit se vajzat më shumë ndihen nevojë për zhvillim të këtyre shkathtësive si rezultat i përfshirjes më të ulët të tyre në aktivitete të rregullta fizike, krahasuar me djemtë. Në pyetje katërmëdhjetë, **„Vallëzimet shoqërore dhe format e ngjashme të aktivitetit janë humbje kohe”** $F=3.599$, sig. = 0.01, djemtë kanë treguar më pajtueshmëri më të lartë me këtë pohim në krahasim me vajzat. Kjo është dukuri e cila paraqitet edhe në rastet e hulumtimeve tjera kur kemi parasysh fazën e zhvillimit socio-psikologjike dhe karakteristikat të cilat i bëjnë të dallueshëm djemtë. Djemtë e kësaj moshe janë shumë më të prirur që të përfshihen në aktivitete fizike në të cilat mund të shfaqin temperamentin e tyre agresiv, si dhe të përfshihen në aktivitete individuale ku mund të tregojnë vlerat e tyre. Për dallim nga djemtë, vajzat janë më shumë të prirura të përfshihen në aktivitete të përbashkëta dhe sidomos në ato veprimtari në

të cilat mund të shfaqin elegancën dhe aspektin e ndjeshmërisë emocionale. Në pyetjën gjashtëmbëdhjetë, „ **Unë do të rekomandoja që secili të merr orën e edukatës fizike si një nga orët më të rëndësishme**”, $F=2.201$, $sig=0.042$, djemtë kanë realizuar vlera më të larta të mesatares aritmetike. Nga kjo pyetje mund të shohim se djemtë më shumë e vlerësojnë orën e edukatës fizike, krahasuar me vajzat. Në pyetjet tjera, në gjithsej 9 nga 16 sa ka pasur pyetësi nuk janë paraqitur ndryshime të cilat mund të interpretohen si domethënëse në kuptimin statistikor.

Edhe në hulumtimet e autorëve tjetër, janë konstatuar ndryshime të ngjashme kur kemi të bëjmë me krahasimin në mes të grupeve aktive dhe sedentare, me mosha dhe kategori të ndryshme. Rezultatet e këtij hulumtimi edhe një herë përforcojnë bindjen se faktorë kyq në përcaktimin e individit për t'u përfshirë me rregull në aktivitet janë qëndrimet të cilat kanë personat e caktuar ndaj të ushtruarit

Tab. 10. Vlerat e mestareve aritmetike të grupit të vajzave dhe djemve

		Group Statistics			
Grupet sipas gjinisë		N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
P1	Vajza	600	2.31	1.382	.056
	Djem	600	2.06	1.298	.053
P2	Vajza	600	2.52	1.306	.053
	Djem	600	2.51	1.276	.052
P3	Vajza	600	2.45	1.215	.050
	Djem	600	2.37	1.263	.052
P4	Vajza	599	3.96	1.008	.041
	Djem	600	3.83	1.111	.045
P5	Vajza	600	4.26	.987	.040
	Djem	600	4.08	1.093	.045
P6	Vajza	600	3.77	1.076	.044
	Djem	600	3.71	1.055	.043
P7	Vajza	600	2.75	1.314	.054
	Djem	600	2.67	1.283	.052
P8	Vajza	600	2.42	1.308	.053
	Djem	600	2.45	1.266	.052
P9	Vajza	600	3.60	1.131	.046
	Djem	600	3.68	1.176	.048
P10	Vajza	600	2.83	1.399	.057
	Djem	600	2.86	1.375	.056
P11	Vajza	600	2.23	1.279	.052
	Djem	600	2.41	1.341	.055
P12	Vajza	600	3.52	1.120	.046
	Djem	600	3.49	1.161	.047
P13	Vajza	600	4.05	.959	.039
	Djem	600	3.93	1.057	.043
P14	Vajza	600	2.20	1.233	.050
	Djem	600	2.44	1.259	.051
P15	Vajza	600	4.03	1.063	.043
	Djem	600	4.04	1.051	.043
P16	Vajza	600	4.00	1.235	.050
	Djem	600	4.14	1.143	.047

Tab.11. T-testi në mes të vajzave dhe djemve

Independent Samples Test										
		F	Sig.	t	df	Sig.	Mean Difference	Std. Error Difference	Interval of the Difference	
									Lower	Upper
P1	Djem / Vjaza	12.753	.000	3.166	1198	.002	.245	.077	.093	.397
P2	Djem / Vjaza	.524	.469	.134	1198	.893	.010	.075	-.136	.156
P3	Djem / Vjaza	.761	.383	1.025	1198	.306	.073	.072	-.067	.214
P4	Djem / Vjaza	13.499	.000	2.175	1197	.030	.133	.061	.013	.253
P5	Djem / Vjaza	2.090	.148	2.938	1198	.003	.177	.060	.059	.295
P6	Djem / Vjaza	.091	.762	.975	1198	.330	.060	.062	-.061	.181
P7	Djem / Vjaza	.900	.343	1.045	1198	.296	.078	.075	-.069	.225
P8	Djem / Vjaza	1.371	.242	-.359	1198	.720	-.027	.074	-.172	.119
P9	Djem / Vjaza	.100	.752	-1.201	1198	.230	-.080	.067	-.211	.051
P10	Djem / Vjaza	.419	.517	-.416	1198	.677	-.033	.080	-.190	.124
P11	Djem / Vjaza	7.745	.005	-2.379	1198	.018	-.180	.076	-.328	-.032
P12	Djem / Vjaza	1.853	.174	.506	1198	.613	.033	.066	-.096	.163
P13	Djem / Vjaza	3.276	.071	2.003	1198	.045	.117	.058	.002	.231
P14	Djem / Vjaza	3.599	.058	-3.243	1198	.001	-.233	.072	-.374	-.092
P15	Djem / Vjaza	.014	.906	-.164	1198	.870	-.010	.061	-.130	.110
P16	Djem / Vjaza	2.201	.138	-2.039	1198	.042	-.140	.069	-.275	-.005

9.2. Ndryshimet në mes të vajzave nga shkollat me kushte të mira dhe kushte jo të mira të punës

Në tabelën Nr. 12 dhe 13 janë paraqitur vlerat e ndryshimit në mes të dy mesatareve aritmetike, vlera e T –testit, si dhe niveli i signifkancës në grupin e vajzave të cilat janë pjesë e shkollave ku ofrohen kushte të mira të punës. Në bazë të rezultateve të fituara me anë të kësaj metode, mund të konstatohet se nga gjithsej 16 pyetje të parashtruara, janë realizuar ndryshime të vlefshme statistikore në 6 nga 16 pyetjet e përfshira në hulumtim.

Nëse e krahasojmë vlerën në të gjitha pyetjet tjera, vlera e T-testit dhe niveli i signifkancës plotësojnë kriterin e vlefshmërisë statistikore për vërtetimin e ndryshimit të rëndësishëm statistikor. Në të gjitha rastet ku janë paraqitur ndryshime të vlefshme statistikore, vlera e signifkancës është më e ulët se 0.05.

Në bazë të këtyre rezultateve të fituara me anë të metodës së T- testit, me të cilën janë hulumtuar ndryshimet në mes të grupit të vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme të punës, që kanë të bëjnë me qëndrimin të cilin kanë të gjithë të hulumtuarit për vlerën e edukimit fizik dhe aspektet tjera të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me të qenit aktiv, mund të konstatohet se grupi i personave të cilët vijnë nga shkolla me kushte më të mira, jo në të gjitha rastet, kanë treguar rezultate të cilat tregojnë interesim më të lartë dhe qëndrime më pozitive ndaj vlerës së aktivitetit fizik. Në pyetjen e parë, „**Edukimi Fizik është për ata që e pëlqejnë sportin por nuk është për mua**”, vlera e $F=9.383$, sig. = .039 dallimi është se vajzat nga shkolla me kushte jo të mira të punës kanë realizuar mesatare më të larta sa i përket deklaramit miratues ndaj këtij pohimi, me çka vërtetohet se vajzat të cilat vijnë nga këto shkolla e konsiderojnë se sporti dhe aktiviteti do të ishte për dikën që me të vërtetë e pëlqen sportin por që nuk duhet domosdo të jetë edhe për ta.

Në pyetjen se „**Unë kënaqem me pjesëmarrjen në sport po aq sa kam dëshirë të largohem nga ai**” $F=4.65$, sig= 0.20, edhe në këtë pyetje vajzat nga shkolla me kushte jo të mira të punës kanë treguar vlera më të larta të mesatares aritmetike, me çka vërtetohet konstatimin se në shkolla ku mungojnë kushtet, automatikisht krijohet edhe bindje më e fuqizuar në atë se edukimi fizik nuk është diçka për të cilin do duhej të punohej me përkushtim dhe se është një lloj me interes të përfshihesh apo të mos përfshihesh në këtë aktivitet.

Në pyetjen e gjashtë „**Me siguri se njëra nga vlerat kryesore të sportit është për të plotësuar kohën e lirë të shoqërisë sonë të automatizuar**: $F=8.421$, $\text{sig}= . 0.00$, kemi vlerë më të lartë të mesatares të vajzave nga shkolla me kushte jo të mira.

Konstatimi nga pyetja e dhjetë „**Do të ishte mirë që në industri të zëvendësoheshin pushime e ushtrimeve me pushime të kafes**”, $F=2.618$, $\text{sig}= 0.044$, edhe në këtë pyetje kemi deklarim me vlera më të larta nga grupi i vajzave me kushte jo të mira të punës, gjë që është vështirë për të dhënë ndonjë shpjegim logjik të kësaj pasqyre të rezultateve.

Në konstatimin nga pyetja e njëmbëdhjetë „**Garimi në sport shpeshherë është një mënyrë për të shkatërruar miqësinë e mirë**”, $F=6.431$, $\text{sig}= . 0.41$, vajzat me kushte jo të mira të punës janë deklaruar në nivel më të lartë pohues, me çka na bënë të kuptojmë se egziston një botkuptim më i theksuar jo i drejtë që me siguri vije si rezultat i mungesës së përfshirjes së mjaftueshme në aktivitetet të organizuar sportive.

Në pyetjen „**Secili duhet të ketë njohuri dhe shkathtësi në disa sporte të cilat mund të përdoren më vonë në jetë**” $F=.318$, $\text{sig}= . 0.50$, edhe në këtë pyetje vajzat nga shkollat me kushte jo të mira shprehen në mënyrë që secili të mund të përfshihet në aktivitete të rregullta gjatë jetës.

Pyetja e fundit në pyetësor „**Unë do të rekomandoja që secili të merr orën e edukatës fizike si një nga orët më të rëndësishme**”. $F=2.05$, $\text{sig}=0.22$, është e qartë se si vajzat nga shkolla me kushte jo të mira, në masë më të madhe kanë deklaruar se janë të gatshme ta rekomandojnë orën e edukatës fizike për të tjerët.

Në nëntë pyetjet tjera rezultatet në mes të grupeve të vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme, nuk janë realizuar ndryshime domethënëse në mes të grupeve me kushte të ndryshme të punës.

Kjo pasqyrë e rezultateve nuk është e tillë që na lejon të interpretohen si rezultate të cilat sigurojnë se egzistojnë ndryshime të rëndësishme sa i përket kushteve të shkollës si faktorë të cilët në mënyrë të saktë përcaktojnë qëndrimin e nxënësve ndaj përfshirjes në edukimin fizik.

Tab. 12. Vlerat e mestareve aritmetike të grupit të vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme të punës

Group Statistics					
Grupet sipas kushteve te shkollës		N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
P1	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	2.19	1.311	.076
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.42	1.441	.083
P2	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	2.47	1.241	.072
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.57	1.368	.079
P3	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	2.33	1.160	.067
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.56	1.259	.073
P4	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	299	3.96	.924	.053
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.96	1.087	.063
P5	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	4.22	1.054	.061
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	4.29	.917	.053
P6	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	3.61	1.097	.063
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.92	1.033	.060
P7	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	2.69	1.288	.074
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.81	1.339	.077
P8	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	2.46	1.307	.075
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.39	1.310	.076
P9	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	3.53	1.113	.064
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.67	1.146	.066
P10	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	2.71	1.349	.078
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.94	1.441	.083
P11	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	2.12	1.222	.071
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.34	1.328	.077
P12	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	3.45	1.133	.065
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.59	1.104	.064
P13	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	3.97	.974	.056
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	4.13	.938	.054
P14	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	2.11	1.169	.067
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.30	1.289	.074
P15	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	4.05	1.079	.062
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	4.01	1.049	.061
P16	Vajzat nga shkollat me kushte te mira te punës	300	3.88	1.251	.072
	Vajzat nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	4.11	1.209	.070

Tab. 13. T-testi në mes vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme të punës

Independent Samples Test										
		F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	Interval of the Difference	
									Lower	Upper
P1	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	9.383	.002	-2.074	598	.039	-.233	.113	-.454	-.012
P2	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	4.399	.036	-.969	598	.333	-.103	.107	-.313	.106
P3	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	4.625	.032	-2.327	598	.020	-.230	.099	-.424	-.036
P4	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	6.593	.010	.039	597	.969	.003	.082	-.159	.165
P5	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	3.186	.075	-.785	598	.433	-.063	.081	-.222	.095
P6	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	8.412	.004	-3.640	598	.000	-.317	.087	-.488	-.146
P7	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	.749	.387	-1.088	598	.277	-.117	.107	-.327	.094
P8	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	.002	.964	.624	598	.533	.067	.107	-.143	.276
P9	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	.348	.556	-1.445	598	.149	-.133	.092	-.315	.048
P10	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	2.618	.106	-2.018	598	.044	-.230	.114	-.454	-.006
P11	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	6.431	.011	-2.048	598	.041	-.213	.104	-.418	-.009
P12	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	.997	.319	-1.569	598	.117	-.143	.091	-.323	.036
P13	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	.319	.573	-1.964	598	.050	-.153	.078	-.307	.000
P14	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	5.097	.024	-1.891	598	.059	-.190	.100	-.387	.007
P15	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	.303	.582	.460	598	.645	.040	.087	-.131	.211
P16	Vajaz kushte te mira/ jo te mira	2.055	.152	-2.290	598	.022	-.230	.100	-.427	-.033

9.3. Ndryshimet në mes të djemve nga shkollat me kushte të mira dhe kushte jo të mira të punës

Në tabelën Nr. 14 dhe 15 janë paraqitur vlerat e ndryshimit në mes të dy mesatareve aritmetike, vlera e T –testit, si dhe niveli i significancës në grupin e djemve të cilët janë pjesë e shkollave ku ofrohen kushte të mira të punës dhe atyre të cilët janë pjesë e shkollave me kushte jo të mira. Në bazë të rezultateve të fituara me anë të kësaj metode, mund të konstatohet se nga gjithsej 16 pyetje të parashtruara, janë realizuar ndryshime të vlefshme statistikore në 8 nga 16 të pyetjeve të përfshira në hulumtim.

Nëse e krahasojmë vlerën në të gjitha pyetjet e tjera, vlera e T-testit dhe niveli i significancës plotësojnë kriterin e vlefshmërisë statistikore për vërtetimin e ndryshimit të rëndësishëm statistikor. Në të gjitha rastet ku janë paraqitur ndryshime të vlefshme statistikore, vlera e significancës është më e ulët se 0.05.

Në bazë të këtyre rezultateve të fituara me anë të metodës së T- testit, me të cilën janë hulumtuar ndryshimet në mes të grupit të vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme të punës, që kanë të bëjnë me qëndrimin të cilin kanë të gjithë të hulumtuarit për vlerën e edukimit fizik dhe aspektet tjera të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me të qenit aktiv, mund të konstatohet se grupi i personave të cilët vijnë nga shkolla me kushte më të mira, jo në të gjitha rastet, kanë treguar rezultate të cilat tregojnë interesim më të lartë dhe qëndrime më pozitive ndaj vlerës së aktivitetit fizik. Në pyetjen e parë, „**Edukimi Fizik është për ata që e pëlqejnë sportin por nuk është për mua**”, vlera e $F=26.228$, $sig=0.11$ dallimi është se djemtë nga shkolla me kushte të këqija të punës kanë realizuar mesatare më të larta sa i përket deklaratimit miratues ndaj këtij pohimi, me çka vërtetohet se djemtë të cilët vijnë nga këto shkolla e konsiderojnë se sporti dhe aktiviteti do të ishte për dikë që me të vërtetë e pëlqen sportin por që nuk duhet domosdo të jetë edhe për ta.

Në pyetjen se „**Unë kënaqem me pjesëmarrjen në sport po aq sa kam dëshirë të largohem nga ai**” $F=18.857$, $sig=0.18$, edhe në këtë pyetje djemtë nga shkolla me kushte jo të mira të punës kanë treguar vlera më të larta të mesatare aritmetike, me çka vërtetohet konstatimin se në shkolla ku mungojnë kushtet automatikisht krijohet edhe bindje më e fuqizuar në atë se edukimi fizik nuk

është diçka për të cilin do duhej të punohej me përkushtim dhe se është njëloj me interes të përfshihesh apo të mos përfshihesh në këtë aktivitet.

Në pyetje e pestë „**Edukimi fizik është një mënyrë për tu larguar nga brengat dhe tensionet e jetës së përditshme**” $F=8.070$, $sig=. 0.00$, kemi vlerë më të lartë të mesatares të djemve nga shkolla me kushte jo të mira të cilët e cmojnë edukimin fizik si një mjet që i ndihmon të largohen nga brengat dhe tensionet e përditshmërive.

Konstatimi nga pyetja e shtatë „**Unë do të përfshihem në edukim fizik vetëm nëse një gjë e tillë më kërkohet**”, $F=20.865$, $sig= 0.000$, edhe në këtë pyetje kemi deklarim me vlera më të larta nga grupi i djemve me kushte jo të mira të punës. Kjo tregon se ata janë më pak të gatshëm të përfshihen vullnetshëm në orën e edukimit fizik dhe se një gjë e tillë e bëjnë vetëm kur kërkohet prej tyre që të bëjnë një gjë të tillë. Kjo tregon se në mungesë të kushteve pjesëmarrja në orët e rregullta të edukatës fizike është jo atraktive.

Në konstatimin nga pyetja e nëntë „**Sporti dhe lojërat e ndërtojnë besueshmërinë sociale**”, $F=14.416$, $sig= . 0.22$, djemtë me kushte të mira të punës janë deklaruar në nivel më të lartë pohues, me çka na bënë të kuptojmë se egziston njëbotëkuptim më i theksuar i drejtëpër vlerën e aktivitetit dhe orës së edukimit fizik edhe në aspektin social duke e perceptuar këtë si një mundësi që përmes aktiviteti tëngrisinbesueshmërinënë rrethin shoqëror në të cilin punojnë.

Nëpyetjen e njëmbëdhjetë, „**Garimi në sport shpeshherë është një mënyrë për të shkatërruar miqësinë e mirë**”, $F=1.466$, $sig=0.002$, djemtë me kushte jo të mira të punës janë deklaruar në nivel më të lartë pohues, me çka na bënë të kuptojmë se egziston njëbotëkuptim më i theksuar jo i drejtë që me siguri vije si rezultat i mungesës sëpërfshirjes së mjaftueshme në aktivitetet të organizuar sportive.

Në pyetjen e trembëdhjetë „**Secili duhet të ketë njohuri dhe shkathtësi në disa sporte të cilat mund të përdoren më vonë në jetë**” $F=.318$, $sig=. 0.50$, edhe në këtë pyetje djemtë nga shkollat me kushte të mira kanë konsideruar se për t’u përfshirë në aktivitet duhet një fond i caktuar i shkathtësive në mënyrë që secili të mund të përfshihet në aktivitete të rregullta gjatë jetës.

Kjo tregon se djemtë në krahasim me grupin e vajzave janë më të vetëdijshëm për rëndësinë që ka fondi i pasur me njohuri të llojllojshme lëvizore në mënyrë që pjesën tjetër të jetës së tyre të jenë me aktiv .

Pyetja e pesëmbëdhjetë „ **Shëndeti dhe fitnesi fizik janë kryesoret për të gjitha aktivitetet tjera jetësore**”. $F=12.965$, $sig=0.00$, dallimi është i rëndësishëm sepse djemtë nga shkolla me kushte të mira të punës kanë treguar nivel më të lartë të vetëdijës për vlerën e edukimit fizik për shëndetin si dhe rëndësinë e tij në kryerjen e detyrave tjera.

Në tetë pyetjet tjera rezultatet në mes të grupeve të djemve nga shkolla me kushte të ndryshme, nuk janë realizuar ndryshime domethënëse në mes të grupeve me kushte të ndryshmet të punës.

Kjo pasqyrë e rezultateve nëse krahasohet me atë të dallimeve në grupin e vajzave nga shkolla me kushte të ndryshme të punës, shumë më qartë vërteton pritjet se në të gjitha deklaratimet djemtë të cilët vijnë nga shkollat të cilët kanë kushte të mira të punës deklarohen shumë më pozitiv në raport me vlerësimin e rëndësisë së edukimit fizik.

Pasqyra e tillë nga të dyja grupet dhe dallimet që egzistojnë në dy grupet e djemve përkundër dallimeve jo shumë të qarta të grupit të vajzave, me siguri vjen për faktin se vajzat në cilën do shkollë, pa marrë parasysh kushtet të cilat ofrohen, janë shumë pak të përfshira në aktivitetet edukatës fizike. Ky është një fenomen i cili ka përmasa mjaftë të gjëra në shkollat e Kosovës dhe duhet të hulumtohet më shumë për të ardhur në përfundime të cilat vijnë si rezultat i gjetjeve konkrete në teren. Kjo qasje e tillë, nga mosha shkollore, përcillet edhe në fazat e tjera të jetës, ku ne kemi një përqindje mjaftë të ulët të përfshirjes së femrave në klube sportive apo edhe në aktivitete rekreative të cilat organizohen në vende të ndryshme.

Tab. 14. Vlerat e mestareve aritmetike të grupit të djemve nga shkolla me kushte të ndryshme të punës

Group Statistics					
Grupet sipas kushteve te shkollës		N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
P1	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	1.93	1.160	.067
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.20	1.411	.081
P2	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	2.43	1.218	.070
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.59	1.330	.077
P3	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	2.25	1.157	.067
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.49	1.353	.078
P4	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	3.88	1.064	.061
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.78	1.156	.067
P5	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	4.24	.966	.056
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.91	1.185	.068
P6	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	3.63	1.012	.058
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.78	1.093	.063
P7	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	2.46	1.152	.066
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.89	1.371	.079
P8	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	2.37	1.224	.071
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.53	1.304	.075
P9	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	3.79	1.069	.062
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.57	1.266	.073
P10	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	2.87	1.361	.079
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.85	1.392	.080
P11	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	2.24	1.315	.076
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.58	1.348	.078
P12	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	3.46	1.104	.064
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.51	1.217	.070
P13	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	4.02	1.005	.058
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.85	1.102	.064
P14	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	2.49	1.242	.072
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	2.38	1.276	.074
P15	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	4.18	.903	.052
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	3.90	1.166	.067
P16	Djemtë nga shkolla me kushte te mira te punës	300	4.21	1.065	.061
	Djemtë nga shkolla me kushte jo te mira te punës	300	4.06	1.213	.070

Tab. 15. T-testi në mes djemve nga shkolla me kushte të ndryshme të punës

Independent Samples Test										
		F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	Interval of the Difference	
									Lower	Upper
P1	Djem kushte te mira/ jo te mira	26.228	.000	-2.560	598	.011	-.270	.105	-.477	-.063
P2	Djem kushte te mira/ jo te mira	6.217	.013	-1.505	598	.133	-.157	.104	-.361	.048
P3	Djem kushte te mira/ jo te mira	18.857	.000	-2.368	598	.018	-.243	.103	-.445	-.042
P4	Djem kushte te mira/ jo te mira	4.777	.029	1.066	598	.287	.097	.091	-.081	.275
P5	Djem kushte te mira/ jo te mira	8.070	.005	3.738	598	.000	.330	.088	.157	.503
P6	Djem kushte te mira/ jo te mira	.100	.752	-1.822	598	.069	-.157	.086	-.326	.012
P7	Djem kushte te mira/ jo te mira	20.865	.000	-4.127	598	.000	-.427	.103	-.630	-.224
P8	Djem kushte te mira/ jo te mira	4.914	.027	-1.549	598	.122	-.160	.103	-.363	.043
P9	Djem kushte te mira/ jo te mira	14.416	.000	2.299	598	.022	.220	.096	.032	.408
P10	Djem kushte te mira/ jo te mira	.686	.408	.208	598	.836	.023	.112	-.197	.244
P11	Djem kushte te mira/ jo te mira	1.466	.227	-3.066	598	.002	-.333	.109	-.547	-.120
P12	Djem kushte te mira/ jo te mira	3.299	.070	-.527	598	.598	-.050	.095	-.236	.136
P13	Djem kushte te mira/ jo te mira	7.236	.007	2.013	598	.045	.173	.086	.004	.342
P14	Djem kushte te mira/ jo te mira	.110	.740	1.005	598	.315	.103	.103	-.099	.305
P15	Djem kushte te mira/ jo te mira	12.965	.000	3.211	598	.001	.273	.085	.106	.440
P16	Djem kushte te mira/ jo te mira	2.380	.123	1.538	598	.125	.143	.093	-.040	.326

10. Vërtetimi i hipotezave

Punimi është ndërtuar duke u udhëhequr nga tri pyetje thelbësore të cilat kanë synuar të vërtetojnë se a egzsitojnë dallime në mes nxënësve në qëndrime sa i përket lëndës së edukatës fizike në varshmëri nga kushtet e punës.

Pyetjet Hulumtuese:

1. A ka dallim në mes të nxënësve meshkuj dhe femra të shkollës së mesme,sa i përket qëndrimit pozitiv apo negativ ndaj orës së edukimit fizik
2. A ekzistojnë dallime në nivelin e qëndrimeve të nxënësve, të nxënësset femra të cilët punojnë në shkolla me kushte të ndryshme
3. A ekzistojnë dallime në nivelin e qëndrimeve të nxënësve, të nxënësve meshkuj të cilët punojnë në shkolla me kushte të ndryshme

Për të verifikuar këto janë ngritur tri hipoteza të cilat me anë të metodave adekuate shkencore është synuar që të vërtetohen.

Hipotezat

H1: Nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme në mes dy gjinive,sa i përket ndryshimeve në qëndrim ndaj edukatës fizike,është vërtetuar,sepse në mes të grupit të vajzave dhe djemve nga gjithsej 16 pyetje, në 7 nga to janë paraqitur ndryshime të rëndësishme.

H2: Nxënësset vajza të cilët punojnë në shkolla të cilat ofrojnë kushte më të mira të punës kanë qëndrim më pozitive se nxënësset të cilët ndjekin shkollat me kushte jo të mira të punës,është vërtetuar pjesërisht, sepse nuk kemi deklarime pohuese dhe mohuese të cilat qartësisht vërtetojnë se cili grup ka qëndrim me pozitiv dhe cili më negativ ndaj edukimit fizik.

H3:Nxënësit meshkuj të cilët punojnë në shkolla të cilat ofrojnë kushte më të mira të punës kanë qëndrim më pozitiv se nxënësit të cilët ndjekin shkollat me kushte jo të mira të punës,është vërtetuar në tërësi, sepse në grupin e djemve nga shkolla me kushte të mira të punës në gati të gjitha pyetjet që pohojnë vlerën e edukatës fizike kemi pasur vlera më të larta të mesatareve aritmetike.

11. Përfundimi me rekomandime

Përmes hulumtimit është synuar që të arrihet të verifikohet se sa mund të ndikojnë kushtet e punës në zhvillimin e qëndrimeve pozitive ndaj aktivitetit fizik dhe ndaj lëndës së edukatës fizike nëpërgjithësi. Nisur nga fakti se procesi mësimorë paraqet dukuri komplekse e cila i nënshtrohet ndikimit të madh të faktorëve të ndryshëm, përmes këtij hulumtimi është arritur të vërtetohet se cili është efekti i dimensioneve të ndryshme motivuese në suksesin përfundimtar në lëndën e Edukatës Fizike, në kushtet dhe rrethanat në të cilat punohet në shkollat tona në të cilat ka ndryshim sa i përket kushteve të punës.

Mostra përbëhet nga gjithsej 1200 respondentë. Në secilën komunë janë përfshirë nxënësit nga shkollat të cilat ofrojnë kushte të mira të punës (Posedojnë sallë dhe hapësira për punë): 100 Meshkuj dhe 100 Femra, dhe shkolla të cilat nuk ofrojnë kushte të mira të punës: (Nuk posedojnë sallë dhe hapësirë për punë) 100 Femra dhe 100 Meshkuj. Nga krahasimet në mes vajzave dhe djemve është konstatuar se në 7 nga gjithsej 16 pyetje, djemtë kanë realizuar vlera më të larta të mesatares aritmetike. Nga kjo pyetje mund të shohim se djemtë më shumë e vlerësojnë orën e edukatës fizike, krahasuar me vajzat.

Sa i përket ndryshimeve në mes vajzave nga shkolla me kushte të mira të punës dhe atyre që nuk kanë kushte të mira, edhe pse në gjysmën e pyetjeve janë paraqitur ndryshime të rëndësishme statistikore, kahja e këtyre dallimeve nuk na lë të konkludojmë se te vajzat kushtet e shkollë kanë përcaktuar qartë se cili grup ka qëndrime më pozitive me grupin tjetër. Me këtë mund të konstatojmë se vajzat janë shumë më pak se meshkujt të angazhuara në orët e edukatës fizike.

Mostër e hulumtimit janë nxënësit e shkollave të Mesme të moshës 15 -18 vjeç. Mostra këtyre dallimeve nuk na lë të konkludojmë se te vajzat kushtet e shkollë kanë përcaktuar qartë se cili grup ka qëndrime më pozitive krahasuar me grupin tjetër. Me këtë mund të konstatojmë se vajzat janë shumë më pak se meshkujt të angazhuara në orët e edukatës fizike.

Për dallim prej vajzave, te grupi i djemve qartësisht është vërejtur se kushtet më të mira të punës kanë ndikuar që nxënësit të kenë qëndrime më pozitive ndaj lëndës së edukatës fizike.

Përkundër faktit se rezultatet nuk kanë vërtetuar në tërësi pasqyrën e pritshme dhe nuk janë vërtetuar si të plota hipotezat, përsëri ekziston një pasqyrë mjaftë e qartë e qëndrimeve që kanë nxënësit e shkollës së mesme ndaj lëndës së edukatës fizike.

Hulumtimi ka treguar, se përkundër që ekzistojnë numër i madh i faktorëve që ndikojnë në qëndrimet e nxënësve, edhe kushtet në të cilat punohet në orën e edukatës fizike paraqesin faktorë të rëndësishëm i cili luan rol të madh në krijimin e qëndrimeve pozitive. Faktorët të cilët kanë ndikuar në paraqitjen e rezultateve të tilla mund të jenë:

- Problemi i mungesës së infrastrukturës përkatëse të Edukatës Fizike, gjë e cila ka shtyrë në një punë jo sistematike me nxënësit.
- Mungesa e përfshirjes së nxënësve në aktivitetet sportive jashtë shkollore. Sidomos kjo ka ndikuar në përgjigjet e marra nga grupi i vajzave.
- Qasja jo serioze e nxënësve në dhënien e përgjigjeve gjatë plotësimit të pyetësorit
- Fakti se faktorët e përfshirë paraqesin vetëm një segment të rëndësishëm nga i cili varet formimi i qëndrimeve në shkollë.

Modeli i përfshirë në hulumtim, për të përcaktuar nivelin e qëndrimeve natyrisht se paraqet modalitet të kufizuar të faktorëve. Një hulumtim më gjithë përfshirës, ku do të trajtoheshin edhe efektet e faktorëve tjerë të kombinuar në modele shumë faktorësh, natyrisht se do të përcaktonte më me saktësi edhe faktorët e ndryshëm që përcaktojnë formimin e qëndrimeve por edhe dallimet që ekzistojnë si rezultat i kushteve të ndryshme.

Të dhënat e fituara mund të shërbejnë të gjithë atyre të cilët janë të përfshirë në proces mësimor për të kuptuar rëndësinë e krijimit të një mjedisi të përshtatshëm, ku egzistojnë kushtet sa më ideale për punë, në mënyrë që punën e tyre didaktiko-profesionale të jenë në gjendje ta drejtojnë, drejtë arritjes së suksesit më të lartë nga ana e nxënësve.

Ky hulumtim mund të shërbejë edhe si bazë e mirë orientuese për hartim të projekteve më gjithëpërfshirës, shumë dimensionale, që lidhen me shpjegimin e natyrës komplekse të relacioneve të faktorëve të ndryshëm që përcaktojnë suksesin shkollor të nxënësve

Mbi rezultatet e këtij hulumtimi tani mund të krijojmë strategji të cilat do të gjenin zbatim nga ana e pedagogëve dhe prindërve në procesin mësimor.

Duke u mbështetur në rezultatet e dalta nga hulumtimi dhe konkluzat e nxjerra nga shfrytëzimi i metodave të përdorura në hulumtim dalin edhe rekomandimet në vijim.

1. DKA dhe Shkollat të investojnë në krijimin e kushteve më të mira për punë në lëndën e edukatës fizike.
2. Mësimdhënësit të përgatiten profesionalisht dhe të kenë të qartë se shfrytëzimi sa më racional dhe më i mirë i hapësirave dhe pajisjeve sportive përveç që e bën më të efektshëm dhe atraktiv procesin mësimorë, ndikon edhe në qëndrimet të cilat nxënësit i kanë ndaj edukatës fizike.
3. Me qëllim të një besueshmërie më të lartë në rezultatet e fituara të përfshihet mostër numerikisht dukshëm më e madhe se mostra e përfshirë në hulumtimin aktual.
4. Një hulumtim longitudinal ku do të krijoheshin kushte për eksperimentim të ndryshimit të kushteve dhe për të shikuar aspektin shkak dhe pasojë, do të mundësonte që mëmë saktësi të nxirreshin përfundimet në lidhje me efektet e kushteve të ndryshme të punës në qëndrimet e nxënësve.
5. Procesi i realizimit të pyetësorëve të përcillet edhe me një fazë parapërgatitore për informimin e nxënësve rreth rëndësisë dhe qëllimit të një hulumtimi të tillë në mënyrë që të ngritet niveli i kuptimit si dhe niveli i seriozitetit në dhënien e përgjigjeve.

12. Vlera teorike dhe praktike e punimit

Shumica e hulumtimeve të bërë në Kosovë kryesisht janë të lidhura drejtpërdrejtë me vlerësimin e parametrave të ndryshëm morfologjik apo lëvizor, apo edhe kombinimet e modeleve të cilat ndikojnë në përmirësim të performancës teknike apo sportive. Shumë pak apo fare nuk ka hulumtime të cilat punën në lëndën e edukatës fizike e lidhin me aspekte të ndryshme qofshin ato të natyrës psikologjike apo sociale.

Pasi që në të gjithë botën, por kohëve të fundit edhe në vendin tonë, po ndryshon statusi i lëndës si dhe rëndësia e edukatës fizike po merr edhe dimensione tjera dhe roli i saj po shihet më shumë në edukimin e nxënësve se sa vetëm në dhënien e instruksioneve praktike dhe në punën e orientuar në përmirësim të shkathtësive lëvizore dhe arritjeve sportive. Procesi i edukimit dhe përgatitja e nxënësve për të qenë aktiv gjatë gjithë jetës është i lidhur shumë me qëndrimet që fëmijët dhe të rinjtë i formojnë gjatë moshës shkollore. Kjo e bën të domosdoshme që të iniciohen hulumtime të cilat synojnë që kanë të bëjnë me zbulimin e faktorëve që ndikojnë në formimin e qëndrimeve sa më pozitiv ndaj aktivitetit fizik.

Me studimin e këtij hulumtimi mendoj se mund të kontribuoj për të kuptuar më mirë qëndrimin e nxënësve për orën e edukatës fizike. Gjithashtu ky studim do të sjell një ndihmes tek mësimdhënësit e edukatës fizike në këto shkolla për të kuptuar dhe analizuar më mirë punën e tyre me këta nxënës si dhe për të kuptuar rëndësinë që kanë kuptimi i qëndrimeve të nxënësve për të përshtatur më mirë strategjinë e intervenimit të mësimdhënësve në orën e edukatës fizike.

Përveç mësimdhënësve, gjetjet e këtij punimi, mund t'ju shërbejnë shumë mirë edhe personave përgjegjës të shkollave dhe DKA-ve komunale në të kuptuarit më të drejtë të domosdoshmërisë për krijim të kushteve sa më të mira të punës në lëndën e edukatës fizike.

13. Literatura

1. Ajzen, I. (2001) Attitudes, Personality and behavior. Chicago: the Dorsey Press
2. American College of Sports Medicine. *ACSM's Guidelines for Exercise Testing and Prescription*, 6th ed.; Lippincott, Williams, & Wilkins: Baltimore, MD, USA, 2000.
3. Ames C. 1992. Achievement goals, motivational climate and motivational processes. In: Roberts GC,
4. Bailey, R. (2006). Physical Education and Sport in Schools: A Review of Benefits and Outcomes. *Journal of School Health*, 76(8), 397-402.
5. Biddle, S.J.H.; Gorely, T.; Stensel, D.J. Health-enhancing physical activity and sedentary behaviour in children and adolescents. *J. Sports Sci.* **2004**, 22, 679-701.
6. Darling, N., Caldeell, L.L., & Smith, R. (2005). Participation in School-Based Extracurricular Activities and Adolescent Adjustment. *Journal of Leisure Research*, 37(1), 51-76.
7. Duda JL, Nicholls JG. 1989. The Task and Ego Orientation in Sport Questionnaire: psychometric
8. Duda JL, Nicholls JG. 1992. Dimensions of achievement motivation in school-work and sport. *Journal of Educational Psychology* 84:290-99. editor. Motivation in sport and exercise. Champaign, IL: Human Kinetics. p. 161-76.
9. Goudas M, Biddle S. 1994. Perceived motivational climate and intrinsic motivation in school physical education classes. *European Journal of Psychology of Education* 9:241-50.
10. Janz, N.K.; Becker, M.H. The health belief model: A decade later. *Health Educ. Quart.* **1984**, 11, 47.
11. Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë, (2014). Planprogramet shkollore. Lënda Edukatë fizike dhe sportive. Prishtinë
12. Nahas, M.V.; Goldfine, B. Determinants of physical activity in adolescents and young adults: The basis for high school and college physical education to promote active lifestyles. *Phys. Educator* **2003**, 60, 42-57.
13. Ntoumanis N, Biddle S. 1999. A review of motivational climate in physical activity. *Journal of Sport Sciences* 17:643-65. properties. Unpublished manuscript.

14. Leslie, E.; Sparling, P.B.; Oen, N. University campus and the promotion of physical activity in young adults: Lessons from research in Australia and the USA. *Health Educ.* **2001**, *101*, 116-125.
15. Sanes C. L. A,(2009). Students' Attitudes Towards Physical Education College of Arts and Sciences. La Suela University
16. Silverman, S. &Subramaniam, P. (1999). Student' attitude to hard physical education and physical activity: A review of measurement issues and outcomes. *Journal Teaching in Physical Education*, 19, 97-102.

15. Pyetësi

Për matjen e qëndrimeve të nxënësve për edukimin fizik do të përdoret pyetësi standard i JimmieIshee i cili ka gjithsej 16 pyetje, është i lehtë të administrohet nga nxënësit dhe ofron edhe mundësinë e kategorizimit të personave në nivele të ndryshme të qëndrimeve. Ky pyetësorë quhet „ PYETËSORI PËR MATJEN E QËNDRIMEVE NDAJ AKTIVITETIT FIZIK”

Qëndrimi ynë ndaj gjërave gjithmonë ndikon në sjelljen tonë ndaj tyre. Çfarë është qëndrimi juaj ndaj Edukimit Fizik dhe Aktivitetit Fizik? Për ta kuptuar duhet të plotësoni pyetësin në vazhdim. Pyetësi është publikuar në periudhën e viteve të 1970 në librin „ Konceptet në Edukimin Fizik”.

Rrumbullakojë secilin deklaram sipas shkallës së mëposhtme:

Pajtohem plotësisht, pajtohem, neutral, nuk pajtohem, nuk pajtohem aspak

1. Edukimi Fizik është për ata që e pëlqejnë sportin por nuk është për mua.
2. Të ushtruarit dhe aktiviteti fizik janë aktivitete të rrezikshme për shëndetin po aq sa janë të dobishme.
3. Unë kënaqem me pjesëmarrjen në sport po aq sa kam dëshirë të largohem nga ai
4. Mu më së shumti më pëlqen të marr pjesë në ato aktivitete në të cilat mund të përfshihem në punë ekipore.
5. Edukimi fizik është një mënyrë për tu larguar nga brengat dhe tensionet e jetës së përditshme.
6. Me siguri se njëra nga vlerat kryesore të sportit është për të plotësuar kohën e lirë të shoqërisë sonë të automatizuar.
7. Unë do të përfshihem në edukim fizik vetëm nëse një gjë e tillë më kërkohet.
8. Kohën të cilën disa njerëz e kalojnë duke ushtruar do të ishte më mirë ta harxhojnë në disa gjëra tjera.
9. Sporti dhe lojërat e ndërtojnë besueshmërinë sociale.
10. Do të ishte mirë që në industri të zëvendësoheshin pushime e ushtrimeve me pushime të kafes.
11. Garimi në sport shpeshherë është një mënyrë për të shkatërruar miqësinë e mirë .
12. Shumica e punëve sigurojnë ushtrime dhe aktivitetin e mjaftueshëm që i duhet një personi.
13. Secili duhet të ketë njohuri dhe shkathtësi në disa sporte të cilat mund të përdoren më vonë në jetë.

14. Vallëzimet shoqërore dhe format e ngjashme të aktivitetit janë humbje kohe.
15. Shëndeti dhe fitnesi fizik janë kryesoret për të gjitha aktivitetet tjera jetësore.
16. Unë do të rekomandoja që secili të merr orën e edukatës fizike si një nga orët më të rëndësishme.

Duhet të shënohet secila pyetje. Rezultatet për pyetjet 3, 4, 5, 6, 9, 10, 13, 15 dhe 16 është si në vijim: Pajtohem plotësisht (5), pajtohem (4), Neutral (3), Nuk pajtohem (2) dhe Nuk pajtohem aspak (1).

Rezultati invers 1, 2, 7, 8, 11, 12 dhe 14; paraqiten kështu Pajtohem plotësisht (1), pajtohem (2), Neutral (3), Nuk pajtohem (4) dhe Nuk pajtohem fare (5).

Duhet të përdoret shkalla e mëposhtme për kategorizim të rezultateve:

- * 72 e mbi -- Shkëlqyeshëm
- * 64 - 71 – Shumë mirë.
- * 56 - 63 – Mbi mesatar.
- * 40 - 55 -- Mesatar.
- * 32 - 39 – Nën mesatar.
- * 24 - 31 -- Dobët.
- * Nën 23 – Shumë dobët.

(EDITOR'S NOTE: Jimmy H. Ishee is associate dean of the College of Health and Applied Sciences at the University of Central Arkansas. His column on fitness appears each Tuesday in the Features section of the Log Cabin Democrat.)

Resyme:Mostra përbëhet nga gjithsej 1200 respondentë. Në secilën komunë janë përfshirë nxënësit nga shkollat të cilat ofrojnë kushte të mira të punës (Posedojnë sallë dhe hapësira për punë): 100 Meshkuj dhe 100 Femra, dhe shkolla të cilat nuk ofrojnë kushte të mira të punës: (Nuk posedojnë sallë dhe hapësirë për punë) 100 Femra dhe 100 Meshkuj. Nga krahasimet në mes vajzave dhe djemve është konstatuar se në 7 nga gjithsej 16 pyetje, djemtë kanë realizuar vlera më të larta të mesatares aritmetike. Nga kjo pyetje mund të shohim se djemtë më shumë e vlerësojnë orën e edukatës fizike,krahasuar me vajzat.

Sa i përket ndryshimeve në mes vajzave nga shkolla me kushte të mira të punës dhe atyre që nuk kanë kushte të mira, edhe pse në gjysmën e pyetjeve janë paraqitur ndryshime të rëndësishme statistikore, kahja e këtyre dallimeve nuk na lë të konkludojmë se te vajzat kushtet e shkollë kanë përcaktuar qartë se cili grup ka qëndrime më pozitive me grupin tjetër. Me këtë mund të konstatojmë se vajzat janë shumë më pak se meshkujt të angazhuara në orët e edukatës fizike.

Mostër e hulumtimit janë nxënësit e shkollave të Mesme të moshës 15 -18 vjeç. Mostra këtyre dallimeve nuk na lë të konkludojmë se te vajzat kushtet e shkollë kanë përcaktuar qartë se cili grup ka qëndrime më pozitive krahasuar me grupin tjetër. Me këtë mund të konstatojmë se vajzat janë shumë më pak se meshkujt të angazhuara në orët e edukatës fizike.

Hulumtimi ka treguar,se përkundër që ekzistojnë numër i madh i faktorëve që ndikojnë në qëndrimet e nxënësve, edhe kushtet në të cilat punohet në orën e edukatës fizike paraqesin faktorë të rëndësishme i cili luan rol të madh në krijimin e qëndrimeve pozitive.

Ky hulumtim mund të shërbejw edhe si bazë e mirë orientuese për hartim të projekteve më gjithëpërfshirës, shumë dimensionale, që lidhen me shpjegimin e natyrës komplekse të relacioneve të faktorëve të ndryshëm që përcaktojnë suksesin shkollor të nxënësve.

Resume: The sample consists of a total of 1200 respondents. In each municipality are included students from the schools offering good working conditions: 100 Men and 100 Women, and schools that do not offer good working conditions: (Do not have room and work space) 100 Women and 100 Men. From the comparisons between girls and boys it is concluded that in 7 out of 16 questions, boys have achieved the highest values of average arithmetic. From this question we can see that more boys value physical education hours compared to girls.

Regarding the differences between girls with good working conditions and those who do not have good conditions, although in half of the questions there have been significant statistical changes, the way these differences do not let us conclude that girls conditions the school has clearly defined which group has more positive attitudes to the other group. By this we can conclude that girls are far less than men engaged in physical education classes.

Research samples are students of middle school aged 15-18 years. Show these differences does not let us conclude that girls school conditions have clearly defined which group has more positive attitudes compared to the other group. By this we can conclude that girls are far less than men engaged in physical education classes.

Research has shown that, although there are a large number of factors affecting student attitudes, the conditions under which physical work hours are present are important factors that play a major role in creating positive attitudes.

This research can also serve as a good guiding ground for the design of more comprehensive, multi-dimensional projects related to the explanation of the natural complexity of the various relationship of factors that determine the success of the school of students.

